

LIGJSHMËRIA DHE TRANSPARENCA NË ANULIMIN E TENDERËVE

Raport i monitorimit në 20 komuna

Autor: Qëndrim Arifi

Redaktore: Albulena Nrecaj

Ekipi i hulumtuesve: Diell Haxhimusa, Leorenta Alija, Valmir Ilazi

Të gjitha të drejtat e këtij botimi i takojnë organizatës Iniciativës për Progres – INPO. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të printohet, distribuohet, kopjohet, shumëfishohet në çfarëdo forme apo mënyrë, elektronike ose të shtypur, pa pajtimin paraprak të Organizatës Iniciativa për Progres. Të drejtat dhe prona intelektuale e këtij botimi mbrohen me Ligjin nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta të Republikës së Kosovës.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Iniciativës për Progres – INPO dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan.

Përkrahur nga:



Përmbajtja

1. Lista e shkurtesave	5
2. Përmbledhje ekzekutive	6
3. Metodologjia.....	8
4. Baza ligjore për anulimin e aktiviteteve të prokurimit.....	9
5. Aktivitetet e anuluar gjatë vitit 2021 në njëzetë (20) komuna.....	11
5.1. Krahasimi i aktiviteteve të anuluar gjatë vitit 2020 dhe 2021	12
6. Mos publikimi i dokumenteve të domosdoshme gjatë anulimit të aktiviteteve të prokurimit.....	13
6.1. Të dhënat në Formularin B10 Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit të paplotësuar dhe të pasakta	16
6.2. Pyetësori me zyrtarët përgjegjës të prokurimit	18
7. Planifikimi i aktiviteteve të anuluar	20
8. Analizë e aktiviteteve të anuluar në njëzetë (20) komuna	22
8.1. Komuna e Deçanit	22
8.2. Komuna e Dragashit.....	22
8.3. Komuna e Ferizajt	23
8.4. Komuna e Glllogocit	24
8.5. Komuna e Gjakovës	25
8.6. Komuna e Gjilanit	25
8.7. Komuna e Kaçanikut	26
8.8. Komuna e Kamenicës.....	27
8.9. Komuna e Klinës	27
8.10. Komuna e Leposaviqit.....	28
8.11. Komuna e Mitrovicës së Veriut.....	28
8.12. Komuna e Pejës	29
8.13. Komuna e Podujevës	30
8.14. Komuna e Prishtinës	30
8.15. Komuna e Prizrenit.....	31
8.16. Komuna e Rahovecit.....	32
8.17. Komuna e Suharekës	33
8.18. Komuna e Shtimes	33

8.19. Komuna e Vitisë.....	34
8.20. Komuna e Vushtrrisë.....	34
9. Komunat që kanë anuluar aktivitete të prokurimit në mënyrë të kundërligjshme	35
10. Roli i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik në mbikëqyrjen e ligjshmërisë së aktiviteteve të anuluar.....	37
11. Roli i Organit Shqyrtues të Prokurimit në anulimin e aktiviteteve të prokurimit	38
12. Gjetjet kryesore	40
13. Rekomandime.....	42
14. ANEKS I - Lista e aktiviteteve të anuluar në njëzetë (20) komuna.....	43

I. Lista e shkurtesave

AK	Autoritet Kontraktues
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
INPO	Iniciativa për Progres
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LPP	Ligji për Prokurimin Publik
OE	Operator Ekonomik
OShP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
RrUOPP	Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik
ZPP	Zyrtarë Përgjegjës i Prokurimit

2. Përmbledhje ekzekutive

Aktivitetet e prokurimit të inicuar nga Autoritetet Kontraktuese (tutje AK) sigurisht që për qëllim kanë marrjen e furnizimit, shërbimit dhe punës së caktuar. E gjithë kjo pas zhvillimit të procedurave të prokurimit deri në nënshkrimin e kontratës. Pa dyshim që gjatë rrugës mund të ndodhin shumë rrethana të cilat mund të dërgojnë deri tek ndërprerja e procedurës së prokurimit, përkatësisht anulimit të aktivitetit të prokurimit.

Anulimi i aktivitetit të prokurimit nuk është, respektivisht nuk do të duhej të ishte veprim i dëshiruar i asnjë AK-je, mirëpo rrethanat e shkaktuara imponojnë ndërprerjen e aktivitetit të prokurimit.¹ Aktin e anulimit të aktivitetit si jo të dëshirueshëm e karakterizojnë pasojat e shumta që ky veprim procedural i shkakton për AK-në. Pasojat e anulimit fillojnë nga ajo se AK, respektivisht qytetarët gjatë vitit përkatës nuk do e marrin furnizimin, shërbimin apo punën e caktuar. Pasoja të tjera lidhen me atë se në disa raste AK-të anulimet i bëjnë në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe për pasojë i ekspozohen rrezikut që të jenë subjekt i paditur nga operatorët ekonomik (tutje OE), humbja e kohës në përgatitje të procedurës dhe zhvillim të saj, e kështu me radhë.

Dështimi në realizimin e planifikimeve buxhetore dhe implementimin e projektve është pasojë tjetër e rëndë që cenon efikasitetin e AK-së në arritjen e objektivave insitucionale. Gjetjet tregojnë se gjatë vitit 2021 në njëzetë (20) komuna, nga njëqind e dyzet (140) aktivitete të anuluar përfundimisht, kanë mbetur pa u shpenzuar gjithsej 21,285,876.06 euro. Madje, përveç që AK-të nuk e marrin furnizimin, shërbimin apo punën e caktuar, ato rrezikojnë që përfundimisht t'i humbin edhe mjetet e dedikuara për ato aktivitete apo projekte, nëse të njëjtat nuk kanë qenë të financuara direkt nga të hyrat vetanake të AK-së.² Mesatarisht secila komunë, gjatë vitit 2021, përfundimisht ka anuluar shtatë (7) aktivitete të prokurimit, ndërsa nga komunat e monitoruara, më së shumti aktivitete të anuluar kanë Komuna e Prizrenit me njëzetë (20) aktivitete të anuluar, pasuar nga Komuna e Ferizajt dhe Suharekës me nga gjashtëmbëdhjetë (16), ndërsa komunat me më së paku aktivitete të anuluar janë Komuna e Leposaviqit me vetëm një (1) aktivitet të anuluar dhe Komuna e Deçanit dhe Shtimes me asnjë aktivitet të anuluar gjatë vitit 2021.

Në përgjithësi komunat gjatë vitit 2021 kanë anuluar aktivitete të prokurimit 47% më shumë sesa gjatë vitit 2021, përkatësisht nga nëntëdhjetë e pesë (95) sa ishte në vitin 2020, në njëqind e dyzet (140) në vitin 2021. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se shumica e komunave të monitoruara nuk publikojnë të gjitha dokumentet e nevojshme lidhur me anulimin e aktivitetit të prokurimit, madje

¹ Për më shumë shih nenin 62 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>, lidhur me nenin 44 të RrUOPP, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

² Për më shumë shih neni 26 i Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/5EA509E4-2933-4524-BD0F-5466A661486F.pdf>.

edhe kur ato dokumente publikohen në shpesh raste të dhënat janë të pasakta dhe kundërthënëse me gjendjen reale.

Të gjeturat dëshmojnë se shumica e aktiviteteve anulohen pas hapjes së ofertave, përkatësisht pasi që AK mëson se cilët OE kanë ofertuar, ndërsa vetëm 23% e aktiviteteve të anuluar gjatë vitit 2021 kanë qenë të planifikuara në planet përfundimtare të prokurimit për vitin 2021.

Rezultatet e monitorimit dëshmojnë se nga njëzetë (20) komunat e monitoruara, tetë (8) prej tyre kanë anuluar aktivitete të prokurimit në kundërshtim me kërkesat ligjore, përkatësisht aktivitetet janë anuluar me veprime të kundërligjshme të AK-së.

Rekomandohet që AK-të të sigurohen që anulojnë aktivitetet e prokurimit në përputhje me dispozitat ligjore, në mënyrë që të mos shkelen të drejtat e OE-ve dhe të shmangët situata ku AK është përgjegjëse për dëmet eventuale të shkaktuara kundrejt OE-ve.

Rekomandohet që AK-të të kujdesen se publikojnë Formularin B10 Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe Formularin B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-së, në secilin rast që anulojnë një aktivitet të prokurimit.

AK-të të kujdesen që aktivitetet e inicuar të jenë në përputhje me planin përfundimtar të prokurimit për vitin përkatës sepse përveç keq planifikimit, inicimi i aktivitetit të pa planifikuar rezulton se i shton gjasat që ai aktivitet të anulohet.

3. Metodologjia

INPO me qëllim që të hartoj një raport përmbajtësor dhe në përputhje me objektivat e projektit ka përdorur metodologji të kombinuar të hulumtimit. Hulumtimi është i shtrirë në njëzetë (20) Komuna, përkatësisht në komunat: Deçan, Dragash, Ferizaj, Gllogoc, Gjakovë, Gjilan, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Suharekë, Shtime, Viti dhe Vushtrri. Për qëllime të këtij hulumtimi aktivitetet e anuluar është konsideruar aktiviteti i cili është anuluar gjatë vitit 2021 dhe për të cilin AK nuk ka zhvilluar ri-tenderim, apo edhe ri -tenderimet janë anuluar gjatë vitit 2021, respektivisht edhe pas ri-tenderimit nuk është arritur të nënshkruhet kontratë gjatë vitit 2021. Pra, pjesë e hulumtimit janë ato aktivitete të cilat përfundimisht janë anuluar gjatë vitit 2021, dhe AK-të gjatë po të njëjtit vit nuk kanë arritur ta kontraktojnë furnizimin, shërbimin apo punën e anuluar.

Fillimisht, nëpërmjet kërkesave për qasje në dokumente publike është kërkuar nga të gjitha komunat e monitoruara të ofrojnë informata rreth numrit të të gjitha aktiviteteve të anuluar gjatë vitit 2021, përfshirë edhe raportin vjetor të kontratave të nënshkruara publike gjatë vitit 2021. Pas kësaj është analizuar se numri i aktiviteteve të anuluar a përputhet me njoftimet për anulim të aktivitetit të prokurimit të publikuara në platformën e-prokurimi dhe për çdo paqartësi apo dilemë është kërkuar informatë shtesë nga komuna përkatëse. Tutje, për secilin aktivitet të anuluar është analizuar se a janë publikuar të gjitha dokumentet e nevojshme kur një aktivitet i prokurimit anulohet, si dhe analizimi i asaj se informatat e vendosura në këto dokumente a janë të sakta.

Pas grumbullimit dhe vërtetimit të të dhënave lidhur me aktivitetet e anuluar, INPO i ka vendosur këto aktivitete në një listë, duke përfshirë titullin e aktivitetit, numrin e prokurimit dhe vlerën e parashikuar, të cilat janë të bashkangjitur në aneks I. Aktivitetet në aneks I janë renditur sipas kohës se kur është anuluar aktiviteti i prokurimit dhe për secilën komunë është monitoruar aktiviteti i parë dhe aktiviteti i fundit për nga koha se kur është anuluar. Hulumtimi përfshinë të gjithë aktivitetet e inicuar gjatë vitit 2021, e të cilat janë anuluar brenda periudhës kohore I janar 2021 deri më 31 mars 2022.

Qëllimi i hulumtimit është pasqyrimi i arsyeve, procedurave të ndjekura dhe ligjshmëria e anulimit të aktiviteteve të prokurimit gjatë vitit 2021 në njëzetë (20) komuna të Republikës së Kosovës. INPO ka analizuar përmbajtjen e dokumentacionit të aktiviteteve të anuluar dhe ka vlerësuar nëse anulimet e aktiviteteve të prokurimit janë bërë sipas rregullave dhe procedurave ligjore. Gjithashtu, në këtë raport është bërë krahasimi në mes të aktiviteteve të anuluar gjatë vitit 2020 dhe aktiviteteve të anuluar gjatë vitit 2021.

Me qëllim që hulumtimi të jetë sa më përmbajtësor dhe profesional, INPO përveç konsultave të vazhdueshme me përfaqësues të komunave, përfaqësues të OE-ve dhe akterë tjerë të cilët direkt apo indirekt kanë qenë të lidhur me këtë hulumtim, ka aplikuar edhe një pyetësor me Zyrtarët Përgjegjës të Prokurimit (tutje ZPP) të njëzetë (20) komunave. Pyetësorit nuk i janë përgjigjur vetëm ZPP-të e Komunës së Dragashit, Gllogocit dhe Kamenicës.

Në fund, drafti i këtij raporti është dërguar tek të gjitha komunat e monitoruara për komente. Komentet e dhëna nga komunat janë pjesë e këtij raporti.

4. Baza ligjore për anulimin e aktiviteteve të prokurimit

AK-të procedurat e prokurimit i fillon me qëllimin që pas përfundimit të tyre të nënshkruajnë kontratë me OE-në apo grupin e OE-ve që konformë kërkesave të dosjes së tenderit arrinë të jetë fitues. Sidoqoftë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit mund të krijohen aso lloj situatash të cilat kërkojnë anulimin e procedurës, përkatësisht e bëjnë të pa mundur që procedura të vazhdoj tutje. Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë (tutje LPP), ka paraparë situata kur për shkak të rrethanave të ndryshme aktiviteti i filluar mund të ndërpritet, përkatësisht të anulohet.³ Meqë procedura e prokurimit përbëhet nga shumë faza, është i rëndësishëm definimi i fazës se kur mund të ndodhë anulimi. LPP-ja ka paraparë që aktivitetet e prokurimit të mund të jenë subjekt i anulimit në dy momentume: (i) para hapjes së tenderëve dhe (ii) pas hapjes së tenderëve.

Sigurisht se anulimi para hapjes së tenderëve pasojat praktike i ka shumë më të vogla. LPP-ja i ka përcaktuar rastet se kur AK-të mund ta përfundojnë aktivitetin e prokurimit.⁴ Legjislacioni sekondar parasheh më në detaje arsyet se kur *duhet* dhe kur *mund* të përfundohet apo anulohet një procedurë apo aktivitet i prokurimit. Pra, sipas legjislacionit në fuqi, në disa raste AK-të e kanë për obligim të anulojnë aktivitetin e prokurimit dhe në disa raste është në diskrecionin e tyre nëse vlerësojnë se duhet bërë një gjë e tillë. Megjithatë, siç u tha më lartë varësisht nga lloji kontratës apo procedurës së prokurimit, arsyet janë të specifikuara si më poshtë:

Pas hapjes së ofertave AK duhet ta anuloj aktivitetin për këto arsye:

- asnjë tenderë nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;
- numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3;
- nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;
- nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- asnjë nga projektet e pranuar në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
- nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
- një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
- nëse AK-ja gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes së procedurës ka përdorur gabimisht opsionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-së është i riparueshëm; ose

³ Neni 62, i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>.

⁴ Po aty.

- nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.⁵

Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen se:

- të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.⁶

Procedura e prokurimit para hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyet e mëposhtme:

- për shkak të ngjarjeve të demonstrueshme dhe / apo arsyeve që janë jashtë kontrollit të AK dhe se nuk ishin të parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve;
- nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes së procedurës ka përdorur gabimisht opsionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm;
- është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar, brenda kontrollit dhe domenit të KRPP-së dhe jashtë kontrollit të AK-së dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP-ja;
- nëse është paraqitur pamundësia e përdorimit të platformës elektronike nga të gjithë përdoruesit si pasojë e problemeve teknike jashtë kontrollit dhe domenit të KRPP-së dhe AK-ve dhe verifikimit e konstatimit nga KRPP-ja.⁷

Anulimet e aktiviteteve të prokurimit të cilat bëhen konformë arsyeve ligjore e mbrojnë AK-në nga çfarëdo përgjegjësie ligjore, përkatësisht nga pretendimet që mund të kenë OE-të, sidomos në procese të shqyrtimit të prokurimit në Organin Shqyrtues të Prokurimit (tutje OShP), apo në rrugë gjyqësore lidhur me shkaktimin e dëmit dhe kërkesat për kompensim si pasojë e anulimit të aktivitetit të prokurimit.⁸

Rrjedhimisht, nëse AK-ja anulon aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me dispozitat ligjore, përkatësisht për arsye të cilat nuk janë të përmendura në ligj dhe të cilat nuk janë të bazuara në arsye objektive të cilat janë lehtësisht të vërfikueshme, atëherë AK mund të përballet me procese administrative dhe gjyqësore që kanë të bëjnë me shkelje të dispozitave ligjore të prokurimit, keqpërdorim i detyrës zyrtare, prishjen e reputacioni të AK-së si dhe humbjen e besimit të publikut në AK.

⁵ Neni 44.5, I RrUOPP, <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

⁶ Po aty, neni 44.6.

⁷ Po aty, neni 44.7.

⁸ Për më shumë shih, po aty, neni 44.8.

5. Aktivitetet e anuluar gjatë vitit 2021 në njëzetë (20) komuna

Anulimi i aktivitetit të prokurimit nënkupton që AK nëpërmjet procedurës së njëjtë të iniciuar nuk do të mund të marr furnizimin, shërbimin apo punën e caktuar dhe nëse nevoja për një aktivitet të tillë ekziston edhe më tutje atëherë duhet që ta inicioj aktivitetin e ri. Pra, anulimi i aktivitetit të prokurimit nënkupton anulimin e të gjitha hapave procedural në kuadër të procesit të prokurimit lidhur me atë aktivitet dhe gjithçka duhet të filloj nga e para.

INPO ka monitoruar aktivitetet e anuluar gjatë vitit 2021 në njëzetë (20) komuna të Republikës së Kosovës dhe të dhënat i gjeni në tabelën më poshtë.

Aktivitetet e anuluar gjatë vitit 2021 në njëzetë (20) komuna ⁹						
Komuna	Anulimet në numra			Anulimet në vlerë		
	Numri i kontratave 2021	Numri i anulimeve 2021	Përqindja	Vlera e kontratave 2021 €	Vlera e aktiviteteve të anuluar 2021 €	Përqindja
Deçan	33	0	0.00 %	2,320,924.20	0,00	0.00 %
Dragash	87	5	5.74 %	2,224,897.94	50,582.00	2.27 %
Ferizaj	70	16	22.85 %	7,525,249.73	4,244,750.00	56.40 %
Glllogoc	93	13	13.97 %	5,220,157.87	737,610.55	14.93 %
Gjakovë	102	8	7.84 %	9,373,363.26	1,110,462.40	11.84 %
Gjilan	42	7	16.66 %	8,014,682.49	2,716,374.76	33.89 %
Kaçanik	72	2	2.77 %	3,362,032.38	35,000.00	1.04 %
Kamenicë	57	6	10.52 %	2,516,612.85	144,850.00	5.75 %
Klinë	83	2	2.40 %	4,505,810.43	114,600.00	2.54 %
Leposaviq	27	1	3.70 %	1,273,691.80	32,000.00	2.51 %
Mitrovicë e Veriut	46	6	13.04 %	5,689,860.90	166,490.00	2.29 %
Pejë	87	3	3.44 %	12,236,893.71	131,669.00	1.07 %
Podujevë	85	4	4.70 %	6,568,963.16	214,899.40	3.27 %
Prishtinë	113	12	10.61 %	18,603,852.68	2,870,852.00	15.43 %
Prizren	147	20	13.60 %	17,875,621.10	2,846,883.10	15.92 %
Rahovec	56	4	7.14 %	13,409,026.23	3,754,510.12	27.99 %
Suharekë	139	16	11.51 %	4,935,635.03	1,231,196.00	24.94 %
Shtime	63	0	0.00 %	2,610,787.76	0.00	0.00 %
Viti	45	3	6.66 %	4,088,186.85	551,790.15	13.49 %
Vushtrri	67	12	17.91 %	5,747,404.43	331,356.58	5.76 %
Gjithsej	1514	140	9.24 %	138,103,654.80	21,285,876.06	15.41 %

Tabela I: Aktivitetet e anuluar gjatë vitit 2021 në njëzetë (20) komuna.

Nga të dhënat në tabelë dëshmohet se numri i aktiviteteve të prokurimit të cilat janë anuluar përfundimisht gjatë vitit 2021 në njëzetë (20) komuna është mjaftë i lartë, përkatësisht janë anuluar njëqind e dyzet (140) aktivitete të prokurimit apo shprehur në përqindje 9.24 % e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2021 nga njëzetë (20) komuna. Për nga numri më i madh i aktiviteteve të anuluar prinë Komuna e Prizrenit me njëzetë (20) aktivitete të anuluar, e pasuar nga Komuna e Ferizajt dhe Suharekës me nga gjashtëmbëdhjetë (16) aktivitete të anuluar.

⁹ **Burimi:** Raportet e kontratave publike të nënshkruara për vitin 2021, platforma e-prokurimi dhe nëpërmjet kërkesave për qasje në dokumente publike.

Nëse krahasohet numri i kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2021 dhe numri i aktiviteteve të anuluar gjatë vitit 2021, atëherë në krye të listës është Komuna e Ferizajt me 22.85%, e pasuar nga Komuna e Vushtrrisë me 17.91%, Komuna e Gjilanit me 16.66% e kështu me radhë.

Në tabelën më lartë është analizuar edhe vlera e parashikuar e aktiviteteve të anuluar gjatë vitit 2021, pastaj këto të dhëna janë krahasuar me vlerën totale të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2021 nga secila komunë. Të dhënat dëshmojnë se vlera e parashikuar e aktiviteteve të anuluar nga Komuna e Ferizajt është e barabartë me 56.40% e vlerës totale të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2021. Pas Komunës së Ferizajt, renditet komuna e Gjilanit me 33.89%, Komuna e Rahovecit me 27.99%, Komuna e Suharekës me 24.94%, e kështu me radhë.

Komuna e Deçanit dhe Shtimes gjatë vitit 2021 nuk kanë asnjë aktivitet të anuluar, përkatësisht aktivitetet e anuluar i kanë ri-tenderuar gjatë vitit 2021 dhe kanë arritur të nënshkruajnë kontrata.

5.1. Krahasimi i aktiviteteve të anuluar gjatë vitit 2020 dhe 2021

INPO gjatë vitit 2021 ka analizuar ligjshmërinë e aktiviteteve të anuluar gjatë vitit 2020 në njëzetë (20) komuna të Republikës së Kosovës.¹⁰ Andaj, është e rëndësishme analizimi dhe krahasimi i numrit dhe vlerës së aktiviteteve të anuluar gjatë vitit 2020 dhe 2021. Në tabelën më poshtë i gjeni të dhënat lidhur me aktivitetet e anuluar gjatë vitit 2020 dhe 2021 në njëzetë (20) komuna.

Krahasimi i aktiviteteve të anuluar gjatë vitit 2020 dhe 2021 ¹¹						
Komuna	Aktivitetet e anuluar gjatë vitit 2020		Aktivitetet e anuluar gjatë vitit 2021		Krahasimi 2021	
	Numri	Vlera €	Numri	Vlera €	Numri ¹²	Vlera €
Deçan	1	87,500.00	0	0.00	-1	0.00
Dragash	11	113,805.58	5	50,582.00	-6	-63,223.58
Ferizaj	11	3,629,177.18	16	4,244,750.00	+5	+615,572.82
Glllogoc	2	27,076.20	13	737,610.55	+11	+710,534.35
Gjakovë	1	1,500.00	8	1,110,462.40	+7	+1,108,962.40
Gjilan	8	1,710,904.37	7	2,716,374.76	-1	+1,005,470.39
Kaçanik	1	4,930.00	2	35,000.00	+1	+30,070.00
Kamenicë	2	22,200.00	6	144,850.00	+4	+122,650.00
Klinë	5	99,200.00	2	114,600.00	-3	+15,400.00
Leposaviq	1	783,220.00	1	32,000.00	=	-751,220.00
Mitrovicë e Veriut	1	592,042.14	6	166,490.00	+6	-425,552.14
Pejë	4	975,475.00	3	131,669.00	-1	-843,806.00

¹⁰ Për më shumë shih raportin "(Pa) Ligjshmëria e tenderëve të anuluar", <http://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2021/10/Raport-Pa-Ligjshm%C3%ABria-e-tender%C3%ABve-t%C3%AB-anuluar.pdf>.

¹¹ **Burimi:** Raporti "Pa ligjshmëria e tenderëve të anuluar" <http://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2021/10/Raport-Pa-Ligjshm%C3%ABria-e-tender%C3%ABve-t%C3%AB-anuluar.pdf>, dhe hulumtimi i aktiviteteve të anuluar gjatë vitit 2021.

¹² **Sqarim:** Shenja (-) do të thotë se aq aktivitete më pak ka të anuluar gjatë vitit 2021, shenja (+) aq aktivitete më shumë ka të anuluar gjatë vitit 2021, ndërsa shenja (=) nënkupton se numri i aktiviteteve të anuluar është i njëjtë si në vitin paraprak.

Podujevë	4	392,708.00	4	214,899.4	=	-177,808.60
Prishtinë	12	1,386,178.00	12	2,870,852.00	=	+1,484,674.00
Prizren	11	704,088.00	20	2,846,883.10	+9	+2,142,795.10
Rahovec	0	0	4	3,754,510.12	+4	+3,754,510.12
Suharekë	8	456,674.10	16	1,231,196.00	+8	+774,521.9
Shtime	1	92,229.96	0	0	-1	-92,229.96
Viti	2	2,850,000.00	3	551,790.15	+1	-2,298,209.85
Vushtrri	9	347,788.99	12	331,356.58	+3	-16,432.41
Gjithsej	95	14,276,697.52	140	21,285,876.06	+45	+7,009,178.50

Tabela 2: Krahasimi i aktiviteteve të anuluar gjatë vitit 2020 dhe 2021.

Sa i përket krahasimit të aktiviteteve të anuluar gjatë vitit 2020 dhe 2021, nga të dhënat në tabelën më lartë përfundohet se kemi një rritje të aktiviteteve të anuluar në nivel të komunave ku nga nëntëdhjetë e pesë (95) aktivitete sa ishin anuluar gjatë vitit 2020, ky numër gjatë vitit 2021 është rritur në njëqind e dyzet (140) apo për 47.3% më shumë se sa vitin e kaluar. Dallim i theksuar vërehet edhe në vlerën e parashikuar të aktiviteteve të anuluar, përderisa në vitin 2020 ishin anuluar aktivitete në vlerë prej, 14,276,697.52 euro, në vitin 2021 kjo vlerë është rritur për 7,009,178.50 euro, duke shkuar në gjithsej 21,285,876.06 euro.

Nëse analizohen komunat, përfundohet se Komuna e Glllogocit ka një rritje të jashtëzakonshme të aktiviteteve të anuluar, nga dy (2) sa kishte gjatë vitit 2020 në trembëdhjetë (13) në vitin 2021, pasuar nga Komuna e Prizrenit nga njëmbëdhjetë (11) sa kishte në vitin 2020 në njëzetë (20) në vitin 2021 dhe Komuna e Suharekës nga tetë (8) sa kishte në vitin 2020 në gjashtëmbëdhjetë (16) në vitin 2021. Ndërsa, ndër komunat që kanë reduktuar numrin e aktiviteteve të anuluar, renditen Komuna e Dragashit e cila nga njëmbëdhjetë (11) anulime sa i kishte në vitin 2020 ka rënë në pesë (5) gjatë vitit 2021, pasuar nga Komuna e Klinës nga pesë (5) në dy (2) aktivitete dhe komunat Deçan, Gjilan, Pejë dhe Shtime të cilat në vitin 2021 kanë nga një (1) aktivitet më pak të anuluar në krahasim me vitin 2020.

6. Mos publikimi i dokumenteve të domosdoshme gjatë anulimit të aktiviteteve të prokurimit

Aktivitetet e prokurimit kalojnë nëpër disa hapa të domosdoshëm procedural nga inicimi deri tek dhënia dhe nënshkrimi i kontratës. Vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, është një hap procedural i cili përveç që nënkupton se AK e ndërprejnë procedurën lidhur me atë aktivitet të prokurimit, në të njëjtën kohë nënkuptohet dhe është ligjërisht e obligueshme prodhimi i disa dokumenteve.

Dokumenti i parë i cili kërkohet menjëherë pas vendimit për anulim të aktivitetit të prokurimit është Formulari B58, apo Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku shpjegohet në mënyrë të detajuar për të gjitha shkaqet dhe arsyet që kanë dërguar AK-në deri tek anulimi i aktivitetit të prokurimit.¹³ Nëse palët në procedurë nuk parashirojnë kërkesa për rishqyrtim, apo kërkesat në fjalë nuk janë të suksesshme, AK pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave, do të përgatitë Formularin B10 Njoftimi për Anulim të aktivitetit të

¹³ Për më shumë lidhur me këtë obligim ligjor, shih neni 44.1 i RrUOPP, <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

prokurimit, pavarësisht nga lloji apo vlera e parashikuar dhe njoftimin e tillë do ta publikojë në platformën e prokurimit elektronik.¹⁴

INPO gjatë monitorimit ka identifikuar raste ku komunat nuk e kanë zbatuar një obligim të tillë ligjor, përkatësisht kanë munguar në platformën e-prokurimi Formularët B10 Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Të dhënat se në cilat komuna ka munguar ky dokument i obligueshëm ligjor i gjeni në tabelën në vazhdim.

Aktivitetet e anuluar me mungesë të dokumenteve të domosdoshme ¹⁵				
Komuna	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Formulari B58	Formulari B10
Ferizaj	Asfaltimi i rrugëve dhe trotuarëve në fsh. Varosh, Fshati i Vjeter, Bibaj dhe Nikadin - projekt tre vjeçar.	656-21-1161-5-1-1	x	√
	Shtëpiaku dhe sanitaria në objektet shkollore dhe institucionet tjera të Komunes së Ferizajt	656-21-3081-2-1-1	x	√
	Dizajni i çmimeve të rregullores së dekoratave llogot e teatrit, galerisë, muzeut, bibliotekës. arkivit, muzeut të kujtesës dhe logot identitare të çmimeve tradicionale. Lot I deri Lot XIII.	656-21-3435-2-2-3	x	√
	Riparimi i rrugëve me asfalt - projekt trevjeçar.	656-21-1997-2-1-1	x	√
	Repilimi i bagetive të imëta kundër sëmundjes Gjuha e Kaltër	656-21-1696-2-2-1	x	√
	Mbushja e bocave me oksigjen dhe furnizimi me manometër për nevoja të QKMF-së në Ferizaj	656-21-3506-1-3-6	x	√
	Përkrahja e fermerëve me paisje - sistem kundër breshërit.	656-21-7513-1-2-1	x	√
	Ndërtimi i shtëpive (kafazëve) për qenë endacak.	656-21-7291-5-2-1	x	√
	Furnizimi i fermerëve me koshere të bletëve	656-21-2137-1-2-1	x	√
Gllgoc	Furnizim me artikuj 1. Material elektrik, veglari dhe llaqe, 2. Artikuj te sanitarisë dhe 3. Artikuj bujqësorë për nevojat e institucioneve komunale – administrates, arsimit dhe shendetesisë së Drenasit	611-21-1216-1-1-1	x	√
	Furnizimi i shkollave me kabinete për kimi, fizikë dhe biologji	611-21-504-1-2-1	x	√
	Mirëmbajtja e deponis inerte - projekt dy vjeqare	611-21-619-2-2-1	x	√
	Hartimi i projekteve zbatuese për nevojat e komunës	611-21-8628-2-1-1	x	√
	Renovimi i objekteve sportive	611-21-8115-5-2-1	x	√
	Rrethojat në QMF dhe AMF dhe ndërtimi i pjerrinave në QMF dhe AMF	611-21-8495-5-2-1	x	√

¹⁴ Për më shumë lidhur me këtë obligim ligjor, shih neni 44.2 i RrUOPP, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shqj/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

¹⁵ **Burimi:** Platforma elektronike e-prokurimi, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakltemNew.aspx>.

Sqarim: Shenja (x) nënkupton se mungon dokumenti, ndërsa shenja (v) nënkupton se dokumenti është i publikuar.

	Mirëmbajtja (servisimi) i paisjeve, Lot I radiologjike, Lot II. Laboratorike dhe mjekësore	611-21-6924-2-2-1	x	√
	Furnizim me paisje muzikore për institucionet shkollore të Komunës së Drenasit	611-21-8111-1-2-1	x	√
	Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative	611-21-7467-5-5-8	x	√
	Dekorimi i qytetit për festa shtetërore dhe kombëtare për vitin 2021, 2022, 2023	611-21-6034-2-2-1	x	√
	Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative	611-21-5845-5-5-8	x	√
	Shërbime konsulente nëpërmjet Marrëveshjeve për Shërbime të Veqanta (Konsulentë individë) për nevojat e Komunës së Drenasit	611-21-229-2-2-1	x	√
Gjakovë	Ndërtimi i rrugës hyrëse në Gjakovë nga ana veriore nga drejtimi i Pejës	632-21-1636-5-1-1	x	√
	Blerja e aparaturave mjekësore (KPSH, stomatologji dhe laborator) dhe jo mjekësore	632-21-3003-1-2-1	x	√
	Furnizim me material për serra dhe mirëmbajtjen e serrave	632-21-4191-1-3-6	x	√
	Furnizim me veshmbathje	632-21-9162-1-2-1	x	√
Gjilan	Ndërtimi i Qendrës Kryesore për Komunitete	651-21-1616-5-2-1	x	√
Kaçanik	Furnizim me oksigjen për QKMF	652-21-2743-1-3-6	x	√
Kamenicë	Furnizim me pajisje mjekësore RTG dhe të Laboratorit	653-21-7723-1-2-1	x	√
	Participimi me donatorë - furnizim, punimi dhe montimi i tezgave në tregun e gjelbërt-Kamenicë	653-21-8146-1-2-1	x	√
Leposaviq	Përgatitja e dokumentacionit teknik të projektit	641-21-8005-2-2-1	x	√
Pejë	Furnizim me artikuj të mirëmbajtjes së objekteve shëndetsore	635-21-3776-1-2-1	x	√
Prishtinë	Furnizimi me artikuj ushqimor për nevojat e kuzhines qendrore - pemë dhe perime	616-21-3026-1-2-1	x	√
	Deratizimi i podrumëve dhe garazheve publike si dhe rrjetit të kanalizimit në Komunën e Prishtinës	616-21-2066-2-1-1	x	√
Prizren	Furnizim me reagensa (D-Dimer dhe teste serologjike) për laborator në kuadër të Shëndetësisë Primare në Komunën e Prizrenit	622-21-3013-1-1-1	x	√
	Hartimi i një udhëzuesi riorganizimi i elementeve të përkohshme (mobilerinë urbane) në qendrën historike në Prizren	622-21-4247-4-2-3	x	√
	Studimi i fizibilitetit dhe projektit ideor i tunelit që lidhë rajonin e Zhupërs me qytetin e Prizrenit	622-21-1817-3-1-2	x	√
	Organizimi i trajnimeve për zejet e filigranit, vekut, plisit, frizer, dizajn grafik dhe marketing, gastronomi, qepje.	622-21-949-2-2-1	x	√
Rahovec	Mirëmbajtja e ngrohjeve qendrore në shkollat e Komunës së Rahovecit	623-21-5374-2-2-1	x	√
Suharekë	Blerja e automjetit zyrtar për QKMF	624-21-8708-1-2-1	√	x
Viti	Mirëmbajtja dhe servisimi i paisjeve të laboratorit në QKMF.	657-21-8721-2-3-6	x	√
Vushtrri	Blerja e shërbimeve të konsulences individuale për Menaxhimin e Kontratave për nevojat e komunës së Vushtrrisë	644-21-6416-2-2-1	x	√

Tabela 3: Aktivitetet e anuluar me mungesë të dokumenteve të domosdoshme.

Nga të dhënat në tabelën më lartë vërtetohet se një numër i konsiderueshëm i komunave nuk zbatojnë kërkesat ligjore gjatë procedurave kur anulohet një aktivitet i prokurimit, përkatësisht nga njëzetë (20) komunat e monitoruara, katërbëdhjetë (14), apo në 70% prej tyre ka raste kur nuk kanë publikuar Formularin B58 për aktivitetet e anuluar.

Konkretisht, Komuna e Gllogocit për dymbëdhjetë (12) aktivitete të anuluar nuk ka publikuar në platformën e-prokurimi Formularin B58, Komuna e Ferizajt nuk ka publikuar këtë formular për nëntë (9) aktivitetet e anuluar, njëjtë kanë vepruar edhe Komuna e Gjakovës dhe Prizrenit për nga katër (4) aktivitete të anuluar, pastaj Komuna e Kamenicës dhe Prishtinës për dy (2) aktivitete të anuluar dhe komunat Gjilan, Kaçanik, Leposaviq, Pejë, Rahovec, Viti dhe Vushtrri, ku për nga një (1) aktivitet të anuluar nuk kanë publikuar këtë dokument të obligueshëm ligjor. Ndërsa, Komuna e Suharekës për një aktivitet të anuluar nuk ka publikuar fare Njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit, përkatësisht Formularin B10.

Mos publikimi i këtyre dokumenteve përveç që është shkelje ligjore, në të njëjtën kohë kufizon të drejtën e OE-ve pjesëmarrës në procedurë që të dinë arsyet e sakta të anulimit të aktivitetit të prokurimit dhe pastaj eventualisht ato arsyeime t'i kundërshtojnë me kërkesë për rishqyrtim apo ankesë. Gjithashtu, mos publikimi i Formularit B58 është largim nga përgjegjësia e ZPP-ve sepse ky dokument pasi të shpjegon arsyet e anulimit të aktivitetit të prokurimit kërkon edhe nënshkrimin e ZPP-së.¹⁶ Pra, në rrethana të tilla vihet në dyshim edhe profesionalizmi dhe arsyeshmëria reale e anulimit të aktivitetit të prokurimit.

6.1. Të dhënat në Formularin B10 Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit të paplotësuara dhe të pasakta

Formulari B10 Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, nënkupton se AK përfundimisht ka vendosur ta anuloi aktivitetin e prokurimit. Ky formular është i aprovuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (tutje KRPP) dhe brenda tij duhet të plotësohen disa të dhëna.¹⁷ Të dhënat që kërkohet të plotësohen në këtë formular kanë të bëjnë me detaje lidhur me aktivitetin e prokurimit të cilin ka vendosur ta anuloi AK-ja, së bashku me identifikimin e AK-së e cila ka marr një vendim të tillë.

Përveç të dhënave që e identifikojnë AK-në, titullin e aktivitetit, vlerën e parashikuar, procedurën e ndjekur, e kështu me radhë, ndër të dhënat shumë të rëndësishme që duhet të vendosen në këtë formularë janë: Informata se AK e bënë anulimin e aktivitetit të prokurimit para apo pas hapjes së ofertave, arsyet e anulimit dhe informatat shtesë, ku zakonisht vendosen detaje lidhur me arsyet e anulimit.

INPO ka evidentuar raste kur të dhënat e paraqitura në njoftimin mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit nuk kanë qenë të sakta, përkatësisht kanë qenë jo reale. Në tabelën më poshtë janë paraqitur dallimet ndërmjet asaj se çfarë është thënë në Formularin B10 lidhur me atë se aktiviteti

¹⁶ Për më shumë shih legjislacionin sekondar të aprovuar nga KRPP, Formulari B58, <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=233>.

¹⁷ Për më shumë, shih legjislacionin sekondar të aprovuar nga KRPP, Formulari B10, <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=233>.

është anuluar para apo pas hapjes së ofertave dhe si ka rezultuar pas verifikimit të të dhënave në formular. Në tabelë janë të paraqitura vetëm komunat në të cilat ka pasur informata të pasakta.

Faza e anulimit të aktiviteteve, kundërthëniet në mes të dhënave në Formularin B10 dhe të dhënave reale pas monitorimit ¹⁸						
Komuna	Numri i aktiviteteve të anuluar	Faza e anulimit të aktivitetit				
		Formulari B10			Të dhënat pas verifikimit	
		Para hapjes	Pas hapjes	Nuk është saktësuar në B10	Para hapjes	Pas hapjes
Dragash	5	0	5	N/A ¹⁹	0	5
Ferizaj	16	4	12	N/A	3	13
Glllogoc	13	2	11	N/A	2	11
Gjakovë	8	2	6	N/A	2	6
Gjilan	7	6	1	N/A	4	3
Kaçanik	2	0	2	N/A	0	2
Kamenicë	6	4	2	N/A	1	5
Klinë	2	0	2	N/A	0	2
Leposaviq	1	0	1	N/A	0	1
Mitrovicë e Veriut	6	0	6	N/A	0	6
Pejë	3	0	3	N/A	0	3
Podujevë	4	0	4	N/A	0	4
Prishtinë	12	2	9	I	2	10
Prizren	20	1	19	N/A	0	20
Rahovec	4	0	4	N/A	0	4
Suharekë	16	3	12	I	1	15
Viti	3	2	0	I	0	3
Vushtrri	12	2	10	N/A	1	11
Gjithsej	140	28	112	3	16	124

Tabela 4: Faza e anulimit të aktiviteteve, kundërthëniet në mes të dhënave në Formularin B10 dhe të dhënave reale pas monitorimit.

Të dhënat në tabelë dëshmojnë se sipas të dhënave të Formularit B10 nga njëqind e dyzet (140) aktivitete të anuluar gjatë vitit 2021, njëzet e tetë (28) prej tyre apo 20% janë anuluar para hapjes së ofertave, kurse njëqind e nëntë (109) apo 77.85%, janë anuluar pas hapjes së ofertave, ndërsa në tri (3) aktivitete të anuluar kjo e dhënë ka munguar në Formularin B10.

Pas analizimit të këtyre të dhënave është vërtetuar se në disa raste ato kanë qenë të pasakta, përkatësisht të ndryshme me atë që është potencuar në Formularin B10. Të dhënat dëshmojnë se jo njëzet e tetë (28) por vetëm gjashtëmbëdhjetë (16) apo 11.42% e aktiviteteve janë anuluar para hapjes së ofertave, ndërsa pjesa më e madhe, përkatësisht njëqind e njëzet e katër (124), apo 88.58% e aktiviteteve janë anuluar pas hapjes së ofertave ose pasi që AK është vënë në dijeni për OE-të që kanë ofertuar. Ashtu siç vërehet edhe në tabelë komunat që kanë ofruar të dhëna

¹⁸ **Burimi:** Analizimi dhe krahasimi i Formularit B10 dhe krahasimi me Formularin B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-së.

¹⁹ **Sqarim:** (N/A) nënkupton se nuk aplikohet.

të pasakta në Formularët B10 janë: Komuna e Ferizajt, Gjilanit, Kamenicës, Prizrenit, Suharekës, Vitisë dhe Vushtrrisë.

Këto të dhëna të pasakta dhe kundërthënëse të paraqitura nga AK-të, përveç që tregojnë jo profesionalizëm të zyrtarëve që kanë për autorizim zhvillimin e procedurave të prokurimit, në të njëjtën kohë japin pasqyrë të pasaktë për publikun dhe lënë hapësirë për të dyshuar se bëhen qëllimshëm dhe me vetëdije.

Qëllimshëm për faktin se dhënia e informatës së pasaktë mund të krijoj përceptim se AK-ja aktivitetin e prokurimit e ka anuluar në përputhje me dispozitat ligjore, ndërsa në disa raste të cilat janë të paraqitura në raport dëshmohet ajo se po të besohej informata e dhënë në Formularin B10, do të konsiderohej anulim i ligjshëm, mirëpo pas analizimit del se arsyeja është krejt tjetër dhe se anulimi i aktivitetit ka qenë i kundërligjshëm.

6.2. Pyetësi me zyrtarët përgjegjës të prokurimit

Në kuadër të hulumtimit të shkaktarëve se pse komunat vazhdojnë ta kanë një numër të konsiderueshëm të aktiviteteve të anuluar, si dhe pse dokumentet si Formulari B10 ngarkohen me gabime të shumta në platformën e-prokurimi.²⁰ INPO ka zhvilluar një pyetësor me ZPP-të e njëzetë (20) komunave të monitoruara. Pyetësit nuk i janë përgjigjur vetëm ZPP-të e Komunës së Dragashit, Glllogocit dhe Kamenicës, ndërsa përgjigjet e ZPP-ve në disa pyetje të pyetësit i gjeni në tabelën në vazhdim.

Përgjigjet e intervistës me zyrtarët përgjegjës të prokurimit ²¹			
Komuna	Sipas mendimit tuaj pse është një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve të anuluar, a mund ta veçoni ndonjë shkaktarë?	Pse në formularin B10 ka raste kur arsyet e anulimit mungojnë?	Pse në disa raste informata se a është anuluar aktiviteti para apo pas hapjes së tenderit, në formularin B10 është e pasaktë?
Deçan	1. Specifikimi jo i mirë nga njësia kërkuese; 2. Mungesa ka edhe LPP i Kosovës; 3. Moskonfiskimi i sigurimit të ankesës nga ana e OShP-së, etj.	Nuk kam koment	Nuk kam koment
Dragash	ZPP nuk i është përgjigj intervistës	ZPP nuk i është përgjigj intervistës	ZPP nuk i është përgjigj intervistës
Ferizaj	Kryesisht për shkak të mungesës së ofertave të përgjegjshme.	Nëse kemi pasur një njoftim mbi vendim të AK dhe në atë njoftim kemi cekur arsyet e anulimit mundet në ndonjë raste me mungu arsyeja tek njoftimi mbi anulim.	Nuk kemi pasur rast të tillë
Glllogoc	ZPP nuk i është përgjigj intervistës	ZPP nuk i është përgjigj intervistës	ZPP nuk i është përgjigj intervistës
Gjakovë	Nuk ka ofertuar asnjë OE	Në komunën tonë nuk ka raste të tilla.	Në komunën tonë nuk ka raste të tilla.

²⁰ Shih platformën, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx>.

²¹ **Burimi:** Zhvillimi i pyetësorëve me ZPP-të e komunave.

Gjilan	Sepse OE-të tejkalojnë vlerën e parashikuar, sepse nuk oferton asnjë OE, asnjë OE nuk është i përgjegjshëm etj.	Është e cekur në njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues	AK nuk ka hasur që kemi pasur raste të tilla
Kaçanik	Nuk kemi pesë oferta të përgjegjshme.	Nuk kemi këso raste	Nuk kemi këso raste
Kamenicë	ZPP nuk i është përgjigj intervistës	ZPP nuk i është përgjigjur intervistës	ZPP nuk i është përgjigjur intervistës
Klinë	Në shumë raste për ofertues jo te përgjegjshëm dhe rastet tjera kur nuk ka pasur asnjë ofertues	Mund të ketë ndodhë kur anulimi është bërë para hapjes.	Nuk kemi.
Leposaviq	Për shkak se nuk ka oferta, për shkak se asnjë ofertë nuk është e përgjegjshme ose në raste tjera për shkak të rrethanave që nuk janë nën ndikimin e AK-së.	Ne gjithmonë deklarojmë arsyet e anulimit të aktiviteti të prokurimit.	Ne nuk japim informacione të pasakta. Ne ndjekim rendin në të cilin publikohen njoftimet.
Mitrovicë e Veriut	Në disa raste për shkak se asnjë kompani nuk konkurron apo plotëson formular mirë, si dhe për faktorë të tjerë të ndryshëm.	Në komunën tonë nuk mungojnë arsyet e anulimit, ato janë gjithmonë të listuara.	Në komunën tonë nuk është kështu, gjithmonë ka të dhëna të sakta.
Pejë	Mungesa e ofertave nga OE-të, dhe mos përgatitje e mirë e specifikave teknike nga njësia kërkuese.	Nuk ka raste ku mungojnë edhe nëse mungojnë arsyen e anulimit mund ta gjeni tek Formulari B58.	Ne kemi plotësuar të gjitha dokumentet dhe ato janë të sakta.
Podujevë	Nuk oferton asnjë OE, ose OE-të që kanë ofertuar kanë qenë të papërgjegjshëm.	Kjo varet prej sistemit të regjenerimit në platformën e prokurimit, ku vet sistemi e rigjeneron dokumentin	Edhe kjo varet prej sistemit të platformës e-prokurimi, e cila nuk i rigjeneron në kohë.
Prishtinë	Për shkak të tejkalimit të vlerës së parashikuar, mungesë e ofertave të përgjegjshme, mungesë e ofertave, gabime në specifika teknike etj.	Nuk kam njohuri që në formularin B10 ka raste kur arsyet e anulimit mungojnë.	Nuk kam njohuri që në disa raste informata se a është anuluar aktiviteti para apo pas hapjes së tenderit është e pasaktë.
Prizren	Nuk ka OE të përgjegjshëm dhe autoriteti nuk ka shpreh gatishmërinë që të njëjtat projekte ti ri-tenderoj.	Nuk ka përgjigje	Nuk ka përgjigje
Rahovec	Në Komunën e Rahovecit, nuk është një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve të anuluar, nga gjithsej 67 aktivitete të realizuara, vetëm 4 aktivitete të prokurimit janë plotësisht të anuluar.	Arsyeja te formulari B10 te neni: V.2) Informacionet shtesë.	Nuk ka përgjigje konkrete
Suharekë	-Mungesa e OE të përgjegjshëm -Përgaditja jo e mirë e specifikimeve teknike -Vendimet e OSHP-së, etj.	-Mund të jetë ndonjë rast ku zyrtarët nuk e bartin informatën në Formularin B10, por në përgjithësi tek arsyeja e anulimit e bartim komplet tekstin e anulimit që e kemi vendos në vendimin për anulim.	Mund të jetë ndonjë gabim teknik, por në përgjithësi janë të dhëna të sakta dhe përputhen me arsyen e anulimit. Tek AK Komuna Suharekë, nuk jam në dijeni që ka raste të tilla.

Shtime	Gabime teknike gjatë hartimit të specifikacionit, mos ofertimi nga operatorët, tejkalimi i vlerës së parashikuar të kontratës, të gjithë OE janë të pa përgjegjshëm, por ka edhe tjerë faktor që ndikojnë në anulim të një procedure si: Vendimi i OShP-së, Njoftim nga KRPP-ja etj.	Në të gjitha aktivitetet e anuluar nga komuna ime , ekzistojnë arsyet e anulimit	Ne si AK, i kemi anuluar dy aktivitete të prokurimit para hapjes së ofertave, dhe tri aktivitete pas hapjes së ofertave, janë të specifikuara në formularin B10.
Viti	Në disa raste më së shpeshti nuk kemi pranuar asnjë ofertë. Kemi shkaqe objektive probleme në platformë ose probleme gjatë procedurës.	Nëse harrojmë ose janë cekur në njoftimin mbi vendimin e AK-së.	Nuk ka përgjigje.
Vushtrri	Vonesa në vlerësim; Mungesë e OE-ve të përgjegjshëm; Mungesë e ofertave.	Nuk kam koment, meqenëse ZPP, i cili ka qenë përgjegjës për këtë çështje, tani më nuk është staf i Komunës së Vushtrrisë.	Nuk kam koment, meqenëse ZPP, i cili ka qenë përgjegjës për këtë çështje, tani më nuk është staf i Komunës së Vushtrrisë.

Tabela 5: Përgjigjet e intervistës me zyrtarët përgjegjës të prokurimit.

Nga përgjigjet e ZPP-ve mund të përfundohet që sipas tyre shkaktarët e anulimeve të shumta kryesisht lidhen me rastet kur asnjë OE nuk oferton lidhur me aktivitetin e caktuar, pastaj OE-të që ofertojnë rezultojnë të papërgjegjshëm, OShP kërkon një gjë të tillë, ndërsa jo pak e rëndësishme dhe shqetësuese mbetet rasti kur ZPP-të deklarojnë që anulimet ndodhin edhe për faktin e gabimeve në specifikimet teknike nga njësitë kërkuese.

Sa u përket të dhënave jo të sakta në Formularin B10 lidhur me fazën se kur është anuluar aktiviteti i prokurimit, ZPP e Komunës së Ferizajt përkundër që INPO ka evidentuar raste të tilla, në pyetësor ka potencuar se “Nuk kemi pasur rast të tillë”. Njëjtë ka potencuar edhe ZPP e Komunës së Gjilanit edhe përkundër që ka një mospërputhje të madhe të të dhënave. ZPP i Komunës së Prizrenit nuk i është përgjigj fare kësaj pyetje, përkundër që në këtë komunë është evidentuar një rast i mos përputhjes së të dhënave.

ZPP i Komunës së Suharekës ka deklaruar se nuk është në dijeni që ka raste të tilla, ZPP i Komunës së Vitisë nuk është përgjigj fare në këtë pyetje, ZPP i Vushtrrisë ka potencuar se “Nuk kam koment, meqenëse ZPP, i cili ka qenë përgjegjës për këtë çështje, tani më nuk është staf i Komunës së Vushtrrisë”. Ndërsa, ZPP i Komunës së Kamenicës nuk i është përgjigj fare pyetësorit, përkundër që INPO edhe në këtë komunë ka hasur në të dhëna jo të sakta sa i përket fazës se kur është anuluar aktiviteti i prokurimit.

7. Planifikimi i aktiviteteve të anuluar

Planifikimi i prokurimit është një dokument i obligueshëm ligjor, i cili kur përpilohet në mënyrë të detajuar dhe është në përputhje të plotë me mundësitë buxhetore dhe nevojat e AK-së, shërben si mekanizëm që mundëson stabilitetin e AK-së dhe redukton mundësinë e situatave të paparashikueshme lidhur me iniciimin e aktiviteteve të prokurimit.

Sipas LPP-së “Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, çdo autoritet kontraktues do të përgatisë, në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet t’i dorëzojë Agjencisë Qendrore të Prokurimit (tutje AQP), një planifikim përfundimtar me shkrim që i identifikon me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues synon ti prokurojë gjatë vitit të tillë fiskal”.²² Plani i prokurimit duhet të jetë i përgatitur në mënyrë profesionale dhe në përputhje të plotë me nevojat dhe mundësitë buxhetore të AK-së.

E rëndësishme është që aktivitetet të cilat AK i inicon të jenë në përputhje me planin e prokurimit, sepse nëse ato nuk janë në plan të prokurimit mundësitë e problemeve me atë procedurë të prokurimit janë shumë më të larta se sa me një aktivitet të planifikuar. Andaj, iniciimi i aktiviteve të paplanifikuara e shton mundësinë që edhe të njëjtit të anulohen, sepse AK si pasojë e keq planifikimit mund ta sjellë vetën në atë pozitë sa që anulimi i aktivitetit mbetet e vetmja alternativë.

Në këtë pjesë INPO ka analizuar nëse aktivitetet e anuluar nga komunitat kanë qenë të planifikuara nga AK-të dhe këto të dhëna i gjeni në tabelën më poshtë.

Planifikimi i aktiviteve të anuluar gjatë vitit 2021 ²³				
Komuna	Nr. i aktiviteve të anuluar	Të planifikuara	Të pa planifikuara	Po, por në vlerë tjetër ²⁴
Deçan	0	0	0	0
Dragash	5	1	3	1
Ferizaj	16	4	6	6
Glllogoc	13	2	5	6
Gjakovë	8	3	2	3
Gjilan	7	0	2	5
Kaçanik	2	0	2	0
Kamenicë	6	1	2	3
Klinë	2	0	2	0
Leposaviq	1	1	0	0
Mitrovicë e Veriut	6	6	0	0
Pejë	3	1	1	1
Podujevë	4	0	3	1
Prishtinë	12	5	3	4
Prizren	20	3	11	6
Rahovec	4	1	2	1
Suharekë	16	5	7	4
Shtime	0	0	0	0
Viti	3	0	1	2
Vushtrri	12	0	4	8
Gjithsej	140	33	56	51

Tabela 6: Planifikimi i aktiviteve të anuluar gjatë vitit 2021.

²² Neni 8, paragrafi 2, i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>.

²³ **Burimi:** Planet përfundimtare të prokurimit për vitin 2021.

²⁴ **Sqarim:** “Po, por në vlerë tjetër”- nënkupton se ato aktivitete kanë qenë të planifikuara, mirëpo kur janë inicuar vlerën e parashikuar e kanë pasur të ndryshme me atë të paraparë me plan përfundimtar të prokurimit.

Të dhënat e paraqitura në tabelë dëshmojnë se shumica e aktiviteteve të anuluar nuk kanë qenë të planifikuara, respektivisht nuk kanë qenë në përputhje të plotë me planin përfundimtar të prokurimit në momentin e inicimit të tyre. Në fakt, vetëm tridhjetë e tre (33) nga njëqind e dyzet (140) aktivitetet e anuluar kanë qenë të planifikuara, pesëdhjetë e një (51) aktivitete të anuluar kanë qenë të planifikuara, mirëpo vlera e parashikuar gjatë inicimit nuk ka qenë e njëjtë si në plan të prokurimit, ndërsa pesëdhjetë e gjashtë (56) aktivitete të anuluar fare nuk kanë qenë të planifikuara.

Nga këto të dhëna përfundohet se predispozitat për anulimin e një aktiviteti të pa planifikuar janë shumë të larta dhe AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në këtë drejtim. Pra, mos planifikimi i duhur përveç rreziqeve të parapara me dispozita ligjore, me vete sjellë edhe rrezikun potencial që aktivitetet e iniciuara në kundërshtim me planin e prokurimit të anulohen.²⁵

8. Analizë e aktiviteteve të anuluar në njëzetë (20) komuna

INPO në njëzetë (20) komunat e monitoruara ka përzgjedh për monitorim aktivitetin e parë dhe aktivitetin e fundit për nga koha e anulimit të tij. Pra, për monitorim në secilën komunë është përzgjedh aktiviteti i parë i anuluar i vitit 2021 dhe aktiviteti i fundit i vitit 2021 që është anuluar nga komuna përkatëse.²⁶ Qëllimi i monitorimit dhe analizimit ka të bëjë me shkaqet e anulimit të aktivitetit të prokurimit, përkatësisht ligjshmëria e anulimit të aktiviteteve të prokurimit.

Në vazhdim janë paraqitur analiza të veçanta për secilën komunë të monitoruar, ku janë evidentuar të gjitha gjetjet lidhur me atë se si ka ardhur deri tek momenti i anulimit, arsyet e anulimit dhe shkeljet eventuale ligjore dhe procedurale gjatë këtij proces.

8.1. Komuna e Deçanit

Komuna e Deçanit gjatë vitit 2021 ka anuluar gjithsej dy (2) aktivitete të prokurimit por të cilat gjatë po të njëjtit vit i ka ri-tenderuar dhe tanimë janë nënshkruar kontratat. Meqë si aktivitete të anuluar në këtë hulumtim janë konsideruar vetëm aktivitetet të cilat janë anuluar dhe të cilat nuk janë ri-tenderuar, apo edhe ri-tenderimet kanë rezultuar të anulohen, konsiderohet që kjo komunë gjatë vitit 2021 nuk ka aktivitete të anuluar.

8.2. Komuna e Dragashit

Komuna e Dragashit gjatë vitit 2021 ka anuluar gjithsej gjashtë (6) aktivitete të prokurimit, ndërsa aktivitetet e përzgjedhura për monitorim janë aktiviteti “Furnizimi me material shpenzues-laboratorik për QKMF-në Dragash” dhe aktiviteti “Ndërtimi i murit mbrojtës në rrugën E Hysajve dhe kubëzimi i rrugës të Shullenjëve në fsh. Xërxë”.

Aktivitetin “Furnizimi me material shpenzues-laboratorik për QKMF-në Dragash”, Komuna e Dragashit me të drejtë e kishte anuluar për shkak se OE i vetëm ofertues kishte ofertuar me çmim 52,000

²⁵ Lidhur me rreziqet që sjellë planifikimi jo i duhur, shih nenin 5, paragrafi 4 të RrUOPP, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

²⁶ **Sqarim:** Aktivitetet e anuluar sipas kohës në të cilën janë anuluar i gjeni të bashkangjitur në Aneks I. Sipas atyre listave janë përzgjedh për monitorim aktiviteti i parë dhe i fundit.

euro, ndërsa vlera e parashikuar e aktivitetit e vendosur nga AK ishte vetëm 10,000 euro.²⁷ Në raste të tilla kur të gjitha ofertat e tejkalojnë vlerën e parashikuar nga AK, anulimi i aktivitetit është plotësisht i ligjshëm.²⁸ Edhe aktivitetin “Ndërtimi i murit mbrojtës në rrugën E Hysajve dhe kubëzimi i rrugës të Shullenjëve në fsh. Xërxë”, AK Komuna e Dragashit e kishte anuluar konformë dispozitave ligjore, përkatësisht për faktin se nuk kishte ofertuar asnjë OE. Sidoqoftë për këtë aktivitet AK kishte shkurtuar afatet për pranimin e tenderëve, gjë e cila mund të ketë ndikuar që për këtë aktivitet të mos ketë asnjë ofertë.²⁹

8.3. Komuna e Ferizajt

Komuna e Ferizajt renditet në mesin e tri (3) komunave që kanë anuluar më së shumti aktivitete të prokurimit gjatë vitit 2021, ndërsa aktiviteti i parë dhe i fundit i përzgjedhur për monitorim është aktiviteti “Asfaltimi i rrugëve dhe trotuareve në fsh. Varosh, Fshati i Vjetër, Bibaj dhe Nikadin - Projekt tre vjeçar” dhe aktiviteti “Furnizimi i fermerëve me koshere të bletëve”.

Aktiviteti “Asfaltimi i rrugëve dhe trotuareve në fsh. Varosh, Fshati i Vjetër, Bibaj dhe Nikadin - Projekt tre vjeçar”, sipas njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit është anuluar për shkak të “Ndryshimeve në paramasë”. INPO në drejtim të Komunës së Ferizajt ka kërkuar dokumentacion dhe informata shtesë se cilat kanë qenë ato ndryshime në paramasë që kanë ndikuar në anulimin e aktivitetit të prokurimit, ndërsa përgjigja ka qenë se “Ju njoftojmë se te ky projekt nuk ka pasur asnjë ndryshim në paramasë, mirëpo ka qenë një gabim teknik apo një mos koordinim mes zyrtarëve të prokurimit të cilët kanë punuar me orar të reduktuar (me ndërrime) shkak masave anti covid dhe kanë zhvilluar procedurën e njëjtë në sistem (e-prokurim) dhe kjo gjë nuk është vërejtur deri në momentin që jemi lajmëruar nga një OE për një lëshim të tillë”. Lidhur me këtë aktivitet përveç që arsyeja e anulimit e shënuar në Formularin B10 nuk ka qenë e vërtetë, Komuna e Ferizajt nuk ka publikuar fare Formularin B58 Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues.³⁰

Pas monitorimit të INPO-s rezulton që pretendimet e Komunës së Ferizajt se janë publikuar dy aktivitete të prokurimit të njëjta është e vërtetë, mirëpo AK në vend që ta anulojë aktivitetin e fundit që është i njëjtë me atë të mëhershmin, AK e bënë të kundërtën, respektivisht e anulon aktivitetin e parë.³¹ Andaj, këto fakte këtë anulim të aktivitetit të prokurimit e bëjnë të kundërligjshëm.

²⁷ Shih procesverbalin e hapjes së tenderëve dhe njoftimin mbi vendimin e AK-së, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1461158.

²⁸ Shih nenin 44.6 të RrUOPP, <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

²⁹ Për më shumë shih, njoftimin për kontratë, procesverbalin e hapjes së tenderëve dhe njoftimin mbi vendimin e AK-së, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1684491.

³⁰ Për më shumë shih aktivitetin e prokurimit, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1327765.

³¹ Shih dokumentet e tenderit për aktivitetin e anuluar, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1327765, shih gjithashtu dokumentet e tenderit të ri i cili është shpallë ditën kur është anuluar aktiviteti i parë, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1327765.

Aktivitetin “Furnizimi i fermerëve me koshere të bletëve”, Komuna e Ferizajt e ka anuluar me kërkesë të njësisë kërkuese e cila anulimin e kishte kërkuar për faktin se kjo lëndë për një kohë të gjatë është në OShP dhe ka një kërkesë të madhe të fermerëve për furnizim me koshere, andaj duhet të iniciohet një procedurë e re.³² Pas monitorimit të INPO-s rezultoi se është e vërtetë se lënda është në OShP, mirëpo edhe përkundër faktit se ky organ është pa panel shqyrtues, megjithatë është nxjerrë një raport i ekspertit shqyrtues dhe i njëjti kishte përfunduar që ankesa e OE ankesës është e bazuar dhe kishte rekomanduar që “AK të eliminoj kriteret kufizuese në Dosjen e Tenderit dhe gjithashtu gjatë hartimit të specifikave të mos i referohet një prodhuesi të caktuar”.³³ Komuna e Ferizajt në vend të adresimit të gjetjeve të ekspertit vendos ta anuloi këtë aktivitet.

Sa i përket arsyes se ka shumë kërkesa lidhur me këtë furnizim dhe duhet të vazhdohet me aktivitet të ri, Komuna e Ferizajt edhe pse kanë kaluar gati dy muaj pas anulimit, ende nuk ka iniciuar aktivitet të ri.

8.4. Komuna e Gllgocit

Gjatë viti 2021 Komuna e Gllgocit ka anuluar gjithsej trembëdhjetë (13) aktivitete të prokurimit, ndërsa aktivitetet e monitoruara janë aktiviteti “Shërbime konsulente nëpërmjet marrëveshjeve për shërbime të veçanta (Konsulentë Individë) për nevojat e Komunës së Drenasit” dhe aktivitetin “Furnizim me artikuj, 1. Material elektrik, veglari dhe llaqe, 2. Artikuj të sanitarisë dhe 3. Artikuj bujqësorë - për nevojat e institucioneve komunale, Administratës, arsimit dhe shëndetësisë së Drenasit”.

Aktiviteti “Shërbime konsulente nëpërmjet marrëveshjeve për shërbime të veçanta (Konsulentë Individë) për nevojat e Komunës së Drenasit”, komuna e ka anuluar pa dhënë ndonjë informatë shtesë se cila është arsyeja e anulimit dhe madje nuk ka publikuar fare as njoftimin mbi vendimin e AK-së.³⁴ INPO ka kontaktuar me ZPP-në e Komunës së Gllgocit për ta mësuar arsyen e anulimit dhe përgjigja ka qenë se bëhet fjalë për Njoftimin Nr.06.2021, të KRPP-së, i cili njoftim kishte kërkuar nga të gjitha AK-të që të heqin dorë nga përdorimi i procedurës për shërbime konsulente për pozita të rregullta të punës. Andaj, mund të përfundojmë që me të drejtë ky aktivitet i prokurimit është anuluar nga Komuna e Gllgocit.

Aktiviteti “Furnizim me artikuj, 1. Material elektrik, veglari dhe llaqe, 2. Artikuj të sanitarisë dhe 3. Artikuj bujqësorë - për nevojat e institucioneve komunale, Administratës, arsimit dhe shëndetësisë së Drenasit”, është anuluar sipas arsyes se “Neni 31.3 i RrUOPP kërkon rreptësisht që oferta të ketë validitet deri te dhënia dhe nënshkrimi i kontratës, prandaj asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës. Duke pas parasysh se jemi në vitin fiskal 2022 Autoriteti Kontraktues ka vendos që kjo procedurë të anulohet”.³⁵ INPO vlerëson se anulimi i aktivitetit të prokurimit është

gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1776015&fbclid=IwAR0SBpqFAdGI4YP9CjXSR-rAhTsTt6xByLtrSRIM_nYoWQJgRnflBKzxs.

³² Shih aktivitetin e prokurimit, [https://e-prokurimi.rks-](https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1790402)

gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1790402.

³³ Për më shumë shih raportin e ekspertit shqyrtues, Nr.389/21, i datës 25.05.2021, <https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Search>.

³⁴ Shih aktivitetin e prokurimit, [https://e-prokurimi.rks-](https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1262873)

gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1262873.

³⁵ Shih Formularin B10, [https://e-prokurimi.rks-](https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1726759)

gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1726759.

hapi i fundit që duhet të ndërmerret nga secili AK në raste të tilla, sepse në këtë rast në vend të anulimit AK është dashur që me kohë të kërkoj zgjatjen e validitetit të tenderit ashtu siç mundësojnë dispozitat ligjore.³⁶ Pra, në këtë rast si pasojë e lëshimeve profesionale ka ardhur deri tek anulimi i aktivitetit të prokurimit.

8.5. Komuna e Gjakovës

Komuna e Gjakovës gjatë vitit 2021 ka anuluar gjithsej tetë (8) aktivitete të prokurimit, ndërsa aktiviteti i parë dhe i fundit i anuluar, të cilët janë përzgjedhë për monitorim janë aktiviteti “Ndërtimi i rrugës hyrëse në Gjakovë nga ana veriore, nga drejtimi i Pejës” dhe aktiviteti “Ndërtimi dhe sanimi i rrugëve me kubëza betoni për lagjet e komuniteteve në Komunën e Gjakovës”.

Aktivitetin “Ndërtimi i rrugës hyrëse në Gjakovë nga ana veriore, nga drejtimi i Pejës”, Komuna e Gjakovës e ka anuluar me të drejtë, kjo pasi që memorandum i bashkëpunimit në mes të Komunës së Gjakovës dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës ishte shkëputur në mënyrë të njëanshme nga kjo e fundit, andaj komuna në mungesë të buxhetit nuk ka mundur të vazhdoj tutje këtë aktivitet.³⁷ INPO ka siguruar vendimin e Ministrisë dhe i njëjti mbanë datën 11 maj 2021, ndërsa njoftimi për anulim është publikuar më 17 maj 2021 nga Komuna e Gjakovës.

Aktivitetin “Ndërtimi dhe sanimi i rrugëve me kubëza betoni për lagjet e komuniteteve në Komunën e Gjakovës”, Komuna e Gjakovës e ka anuluar me arsyen se asnjë OE nuk ka qenë i përgjegjshëm.³⁸ Pas monitorimit të INPO-s rezulton se anulimi është në përputhje me kërkesat ligjore, pasi që i vetmi OE i cili kishte konkurruar kishte rezultuar si administrativisht i papërgjegjshëm.

8.6. Komuna e Gjilanit

Gjatë vitit 2021 Komuna e Gjilanit ka anuluar përfundimisht shtatë (7) aktivitete të prokurimit, ndërsa aktivitetet e përzgjedhura për monitorim janë aktiviteti “Ndërtimi i Qendrës Kryesore për Komunitete” dhe aktiviteti “Pastrimi i objekteve komunale dhe shëndetësore në Komunën e Gjilanit”.

Aktiviteti “Ndërtimi i Qendrës Kryesore për Komunitete”, është anuluar pa ndonjë arsye të qartë, përderisa në njoftimin mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit nuk ofrohet ndonjë e dhënë lidhur me arsyen e anulimit, në të njëjtën kohë kjo nuk shpjegohet as në njoftimin mbi vendimin e AK-së.³⁹ INPO më 24 maj 2022 i është drejtuar ZPP-së me një e-mail, ku janë kërkuar arsyet reale se pse është anuluar ky aktivitet i prokurimit, mirëpo ZPP nuk është përgjigjur për këtë çështje. Anulimi i aktivitetit të prokurimit në këtë formë, pra duke mos shpjeguar arsyet e anulimit

³⁶ Shih nenin 31.4 të RrUOPP, <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

³⁷ Për më shumë shih aktivitetin e prokurimit, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1393974.

³⁸ Shih aktivitetin e prokurimit, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1733647.

³⁹ Shih Njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe njoftimin mbi vendimin e AK-së, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1351068.

përveç që është jo transparencë dhe jo profesionalizëm nga ZPP, në të njëjtën kohë lë dyshime se ky aktivitet është anuluar në kundërshtim me kërkesat ligjore.

Aktivitetin “*Pastrimi i objekteve komunale dhe shëndetësore në Komunën e Gjilanit*”, Komuna e Gjilanit e ka anuluar për shkak të lëshimeve profesionale e teknike, përkatësisht në Formularin B10 ndër tjerash është theksuar se “*Pasi kemi pasur kërkesa për rishqyrtim rreth Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë kemi pezulluar aktivitetin, mirëpo vendimet mbi kërkesat për rishqyrtim AK nuk ka mundur ti publikoj brenda afatit të caktuar pasi që ka qenë ditë feste, pastaj nga dt.10.01.2022 deri me dt. 17.01.2022 zyra e prokurimit ka qenë pa zyrtarë përgjegjës të prokurimit. Në sistemin e-prokurim, tani e kemi të pa mundur të bëjmë korigjimin e Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë, pasi që butoni korigjim i procedurës është i mbyllur*”.⁴⁰Për këtë çështje është kërkuar ndihmë edhe nga KRPP-ja, mirëpo sistemi është i asaj natyre që nuk lejon ndërhyrje të tilla. Pra, ky aktivitet është anuluar për shkak të lëshimeve të AK-së që me kohë të veprohet karshi kërkesave për rishqyrtim të OE-ve dhe për pasojë ky shërbim ka dështuar që të merret gjatë vitit 2021 nga ana e Komunës së Gjilanit.

8.7. Komuna e Kaçanikut

Komuna e Kaçanikut gjatë vitit 2021 ka anuluar gjithsej dy (2) aktivitete të prokurimit, ndërsa që të dy këto aktivitete janë monitoruar nga INPO. Aktivitetet e monitoruara janë aktiviteti me titull “*Furnizim me oksigjen për QKMF*” dhe aktiviteti “*Mirëmbajtja dhe servisimi i aparaturave mjekësore në QKMF-në, Kaçanik*”.

Aktivitetin “*Furnizim me oksigjen për QKMF*”, Komuna e Kaçanikut e ka anuluar me arsyen se nuk ka ofertuar asnjë OE. INPO ka kërkuar qasje në procesverbalin e hapjes, ndërsa ka pranuar një procesverbal në versionin word dhe të pa nënshkruar nga komisioni i hapjes dhe ZPP i komunës. Gjithashtu, për këtë aktivitet në platformën e-prokurim nuk është publikuar asnjë dokument tjetër përpos Formularit B10.⁴¹

Aktivitetin “*Mirëmbajtja dhe servisimi i aparaturave mjekësore në QKMF-në, Kaçanik*”, Komuna e Kaçanikut e ka anuluar me arsyetimin se OE i vetëm ofertues është i pa përgjegjshëm.⁴² Pas monitorimit të INPO-s rezulton se Komuna e Kaçanikut me të drejtë e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit, pasi që OE nuk kishte ofruar dokumentet dhe dëshmitë e nevojshme sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit. Sidoqoftë, Komuna e Kaçanikut duhet të interesohet dhe të gjej shkaktarët se pse për këtë aktivitet nuk ka pasur interesim të duhur të OE-ve, përndryshe nëse nuk adresohen shkaktarët rrezikohet që edhe në të ardhmen AK të përballet me situatë të njëjtë.

⁴⁰ Për më shumë shih aktivitetin e prokurimit, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1733138.

⁴¹ Shih aktivitetin e prokurimit, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1400579.

⁴² Për më shumë shih aktivitetin e prokurimit, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1685257.

8.8. Komuna e Kamenicës

Në mesin e gjashtë (6) aktiviteteve të anuluar gjatë vitit 2021 nga Komuna e Kamenicës, për monitorim janë përzgjedh aktivitetit “Shërbime juridike dhe të përfaqësimit për nevojat e Komunës së Kamenicës” dhe aktiviteti “Restaurimi i Kishës Ortodokse në Shipashnicë të Poshtme”.

Aktivitetin “Shërbime juridike dhe të përfaqësimit për nevojat e Komunës së Kamenicës”, Komuna e Kamenicës e ka anuluar me arsyen se nuk ka pasur asnjë OE të përgjegjshëm.⁴³ Pas monitorimit të INPO-s rezulton se me të drejtë është anuluar ky aktivitet i prokurimit pasi që OE i vetëm ofertues në pozicionin 3.2 “Kontest me vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri në 10.000€”, kishte ofertuar me çmime më të larta se sa tarifa e Odës së Avokatëve, ndërsa në kërkesat e Dosjes së Tenderit ka ekzistuar njoftimi që ofertat nuk duhet t’i tejkalojnë këto tarifa.⁴⁴

Edhe aktivitetin “Restaurimi i Kishës Ortodokse në Shipashnicë të Poshtme”, Komuna e Kamenicës e kishte anuluar me të drejtë për shkak se asnjë nga katër (4) OE-të që kishin ofertuar nuk kanë qenë të përgjegjshëm, përkatësisht nuk kanë plotësuar kërkesat minimale dhe kërkesat lidhur me kapacitetin financiar, teknik e profesional.⁴⁵

8.9. Komuna e Klinës

Komuna e Klinës gjatë vitit 2021 ka anuluar vetëm dy (2) aktivitete të prokurimit, të cilët edhe janë monitoruar lidhur me ligjshmërinë e anulimit. Titujt e aktiviteteve të anuluar janë “Ndërtim i serrave për përfituesit individual” dhe “Shërbime të veçanta - specialist të gjeodezisë”.

Aktivitetin “Ndërtim i serrave për përfituesit individual”, Komuna e Klinës e ka anuluar me arsyen se të gjithë OE-të ofertues e kanë tejkalluar vlerën e parashikuar nga AK për këtë aktivitet. Pas monitorimit të INPO-s rezulton se vlera e parashikuar e këtij aktiviteti ka qenë 108,000 euro, ndërsa oferta më e lirë prej tre (3) OE sa kanë ofertuar për këtë aktivitet ishte 166,000.75 euro, apo 58,000.75 euro më e shtrenjtë se vlera e parashikuar.⁴⁶ Andaj, ky anulim është në përputhje me dispozitat ligjore, përkatësisht në nenin 44.6 të RrUOPP, ku taksativisht thuhet se AK mund ta anuloj aktivitetin e prokurimit kur të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.⁴⁷

Aktivitetin “Shërbime të veçanta - specialist të gjeodezisë”, Komuna e Klinës e ka anuluar me arsyen se nuk ka pranuar asnjë ofertë.⁴⁸ Pas monitorimit të INPO-s, edhe ky anulim rezulton të jetë i ligjshëm për faktin se AK nuk ka pranuar asnjë ofertë dhe në bazë të dispozitave ligjore në këtë

⁴³ Shih aktivitetin e prokurimit, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1378141.

⁴⁴ Shih Dosjen e Tenderit, kërkesat teknike/profesionale, pika 4, [file:///C:/Users/Q%C3%ABndrim%20Arifi/Downloads/B05%20Njoftim%20per%20Kontrat%20\(12\).Pdf](file:///C:/Users/Q%C3%ABndrim%20Arifi/Downloads/B05%20Njoftim%20per%20Kontrat%20(12).Pdf).

⁴⁵ Për më shumë shih Njoftimin mbi vendimin e AK-së, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1735371.

⁴⁶ Për më shumë shih aktivitetin, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1440750.

⁴⁷ Për më shumë shih nenin 44.6 të RrUOPP, <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

⁴⁸ Shih aktivitetin e prokurimit, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1696930.

rast aktiviteti i prokurimit duhet të anulohet.⁴⁹ Sidoqoftë, Komuna e Klinës duhet t'i analizoј shkaktarët se pse për këtë aktivitet nuk ka ofertuar asnjë OE, në mënyrë që në të ardhmen të sigurohet që të mos përsëritet një situatë e njëjtë dhe komuna të mbetet pa shërbimin e kërkuar.

8.10. Komuna e Leposaviqit

Komuna e Leposaviqit gjatë vitit 2021 ka anuluar vetëm një (1) aktivitet të prokurimit, aktiviteti i anuluar mbanë titullin *“Përgatitja e dokumentacionit teknik të projektit”*. Këtë aktivitet Komuna e Leposaviqit e ka anuluar me arsyen se *“Në terren kanë lindur disa mosmarrëveshje për dy projekte në lidhje me marrëdhëniet pronësore-juridike, ku persona të caktuar po kontestojnë pronësinë e tokës ndërtimore, ku është dashur të kalonin rrugët e parashikuara”*.⁵⁰ Këtë aktivitet Komuna e Leposaviqit e ka anuluar pasi që janë hapur ofertat, përkatësisht pasi AK është vënë në dijeni se cilët OE kanë ofertuar për këtë aktivitet.

Anulimi i aktivitetit në këtë fazë dhe për arsyet e cekura nga Komuna e Leposaviqit, përveç që dëshmon një keq planifikim të komunës, në të njëjtën kohë anulimin e bënë të kundërligjshëm sepse aktiviteti nuk mund të anulohet pas hapjes së ofertave për këto arsye. Nëse me të vërtetë kanë ekzistuar këto probleme komuna ka mundur që para hapjes së ofertave ta bëjë anulimin e aktivitetit, mirëpo jo pasi që ka mësuar se cilët janë OE-të ofertues. Këto veprime të kundërligjshme nuk e mbrojnë AK-në nga paditë për kompensim dëmi të parashtruar nga OE-të të cilët kanë pësuar dëme si pasojë e keq planifikimit të komunës dhe veprimeve të kundërligjshme lidhur me anulimin e aktivitetit.⁵¹

8.11. Komuna e Mitrovicës së Veriut

Përkundër që gjatë vitit 2020, Komuna e Mitrovicës së Veriut ka anuluar vetëm një (1) aktivitet të prokurimit, gjatë vitit 2021 e njëjta komunë ka anuluar gjithsej gjashtë (6) aktivitete. Aktivitetet e përzgjedhura për monitorim janë aktiviteti *“Prokurimi i pajisjeve digjitale (tabletëve) për nevojat e shkollave të mesme”* dhe aktiviteti *“Furnizimi i tonerit për nevojat e shkollës fillore në Mitrovicën e Veriut”*.

Aktivitetin *“Prokurimi i pajisjeve digjitale (tabletëve) për nevojat e shkollave të mesme”*, Komuna e Mitrovicës së Veriut e ka anuluar me arsyen se *“Vlera e vlerësuar e kontratës nuk ishte bërë mirë. Gjegjësisht, vlera e vlerësuar është 25,000 dhe nuk ka aq shumë fonde të alokuara në buxhetin komunal për këtë tremujor, kështu që prokurimi shtyhet deri në ndarjen tjetër”*.⁵² Ky aktivitet është anuluar pas hapjes së ofertave dhe për këtë aktivitet kanë ofertuar gjithsej pesë (5) OE dhe që të gjithë kanë

⁴⁹ Po aty, neni 44.5, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

⁵⁰ Për më shumë shih aktivitetin e prokurimit, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1708283.

⁵¹ Shih, nenin 44.8 të RrUOPP ku përcaktohet qartë se vetëm në cilat raste AK është e mbrojtur nga pretendimet për shkaktim të demit nga OE-të, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

⁵² Shih aktivitetin e prokurimit, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1389863.

ofertuar me çmim më të lirë se sa vlera e parashikuar.⁵³ Anulimi i aktivitetit në këtë formë dhe për këto arsye është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe AK do të jetë përgjegjëse për çdo dëm të shkaktuar ndaj OE-ve të cilët kanë marr pjesë në këtë tender.

Aktivitetin “Furnizimi i tonerit për nevojat e shkollës fillore në Mitrovicën e Veriut”, Komuna e Mitrovicës së Veriut e ka anuluar me arsyen se asnjë nga OE-të ofertues nuk kanë qenë të përgjegjshëm. Pas monitorimit të INPO-s rezulton se ky aktivitet është anuluar me të drejtë dhe anulimi është në përputhje me kërkesat ligjore, sepse asnjëri nga dy (2) OE-të ofertues nuk kanë qenë të përgjegjshëm, përkatësisht nuk i kanë ofruar të gjitha kërkesat e kërkuara me Dosje të Tenderit.⁵⁴

8.12. Komuna e Pejës

Komuna e Pejës gjatë vitit 2021 ka anuluar tri (3) aktivitete të prokurimit, ndërsa aktivitetet e përzgjedhura për monitorim të ligjshmërisë së anulimit janë aktiviteti “Blerja e një autoambulance për urgjencën e qytetit” dhe aktiviteti “Blerja e dy autokombi për QKMF-në, LOT II”.

Aktiviteti “Blerja e një autoambulance për urgjencën e qytetit”, është anuluar për shkak se “Komisioni vlerësues ka vërejtur se njësisë kërkuese (Drejtorati i Shëndetësisë) i kanë rrjedhur disa gabime në paramasa dhe paralogari të cilat e pamundësojnë përzgjedhjen e OE fitues, sepse kemi vërejtur se mund të na paraqiten problem në pranimin e mallit, prandaj jemi të shtyer që ta anulojmë këtë aktivitet. Dhe në të ardhmen njësisë kërkuese të jetë më e qartë dhe më e saktë në përpilimin e paramasës dhe e specifikimeve teknike”.⁵⁵ INPO ka kërkuar sqarime shtesë nga ZPP i Komunës së Pejës për të mësuar se cilat kanë qenë ato lëshime në paramasë që kanë sjellë në situatë AK-në që ta anuloi aktivitetin e prokurimit, ndërsa përgjigja ka qenë e njëjtë si ajo e cekur më lartë dhe se ky anulim ka ndodhur nga ZPP paraprak, kurse ZPP i tanishëm nuk ka informata të tjera lidhur me arsyet e anulimit.

Komuna e Pejës këtë aktivitet e ka anuluar pas hapjes së ofertave, përkatësisht pasi ka parë se kush janë katër (4) OE-të ofertues për këtë aktivitet. Anulimi i aktivitetit të prokurimit pas hapjes së ofertave me arsyet e gabimeve në paramasë është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe rrjedhimisht anulimin e bënë të kundërligjshëm.⁵⁶ Një anulim me arsye të tilla AK-në e ekspozon para rrezikut të shpërblimit të dëmeve që u janë shkaktuar OE-ve ofertues si pasojë e veprimeve të kundërligjshme, pa harruar faktin se si pasojë e këtij veprimi AK mbetet pa furnizimin e caktuar.

Aktivitetin “Blerja e dy autokombi për QKMF-në, LOT II”, Komuna e Pejës e ka anuluar me arsyen se nuk ka ofertuar asnjë OE. Pas monitorimit të INPO-s, rezulton se me të drejtë është anuluar

⁵³ Po aty, procesverbali i hapjes së tenderëve, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1389863.

⁵⁴ Për më shumë, shih aktivitetin e prokurimit, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1700262.

⁵⁵ Shih njoftimin për vendimin e AK-së dhe dokumentet tjera të aktivitetit të prokurimit, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1386725.

⁵⁶ Shih rastet se kur mund të anulohet aktiviteti i prokurimit pas hapjes së ofertave, neni 44.5 i RrUOPP, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

ky aktivitet pasi që nuk ka ofertuar asnjë OE dhe në këtë rast sipas rregullave ligjore anulimi i aktivitetit është i pashmangshëm.⁵⁷

8.13. Komuna e Podujevës

Gjatë vitit 2021 Komuna e Podujevës ka anuluar gjithsej katër (4) aktivitete të prokurimit, aq sa kishte anuluar edhe gjatë vitit 2020. Aktivitetet të cilat i janë nënshtruar monitorimit lidhur me ligjshmërinë e anulimit janë aktiviteti me titull “*Ekzaminimi i materialeve ndërtimore*” dhe aktiviteti “*Furnizimi me goma për automjete të institucioneve*”.

Aktivitetin “*Ekzaminimi i materialeve ndërtimore*”, Komuna e Podujevës e ka anuluar me arsyen se nuk ka pasur OE të përgjegjshëm.⁵⁸ Pas monitorimit të INPO-s rezulton se për këtë aktivitet kanë ofertuar gjithsej tre (3) OE dhe asnjëri nga ta nuk i ka ofruar të gjitha dëshmitë e kërkuara nga AK, andaj me të drejtë dhe në përputhje me kërkesat ligjore është anuluar ky aktivitet i prokurimit.

Edhe aktiviteti “*Furnizimi me goma për automjete të institucioneve*”, është anuluar me arsyen se AK nuk ka pranuar asnjë ofertë të përgjegjshme.⁵⁹ Pas monitorimit të ligjshmërisë së anulimit të këtij aktiviteti, rezulton se Komuna e Podujevës me të drejtë ka anuluar edhe këtë aktivitet të prokurimit, pasi që OE i vetëm ofertues nuk e ka plotësuar listën e çmimeve për pozicionet 6,8,9 dhe 10, përkatësisht goma për Landrover, goma për Iveco, goma për Steyer Daimler Puch 10R22.5 dhe goma për Steyer Daimler 9.00R20. Sipas dispozitave ligjore, kur nuk oferton asnjë OE i përgjegjshëm atëherë anulimi i aktivitetit të prokurimit është i detyrueshëm për AK-në.⁶⁰

8.14. Komuna e Prishtinës

Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2021 ka anuluar gjithsej dymbëdhjetë (12) aktivitete të prokurimit, ndërsa dy aktivitetet e monitoruara janë aktiviteti “*Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës*” dhe aktiviteti “*Ndërtimi i çerdhes Xixëllonjat*”.

Aktivitetin “*Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës*”, komuna e ka anuluar me arsyen se asnjëri nga OE-të ofertues nuk kishte qenë i përgjegjshëm.⁶¹ Pas monitorimit të INPO-s, rezulton se komuna me të drejtë dhe në mënyrë të ligjshme ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit pasi që asnjëri nga pesë (5) OE-të që kanë ofertuar

⁵⁷ Për më shumë shih njoftimi mbi vendimin e AK-së https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1654314, shih gjithashtu edhe nenin 44.5 të RrUOPP, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

⁵⁸ Shih aktivitetin e prokurimit, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1419548.

⁵⁹ Për më shumë shih aktivitetin e prokurimit, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1668946.

⁶⁰ Shih neni 44.5, paragrafi 2 i RrUOPP, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

⁶¹ Për më shumë shih aktivitetin e prokurimit, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1372731.

nuk kanë qenë të përgjegjshëm, përkatësisht nuk i kanë plotësuar të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Edhe aktivitetin “Ndërtimi i çerdhes Xixëllonjat”, Komuna e Prishtinës e ka anuluar me arsyen se asnjëri nga OE-të ofertues nuk ka qenë i përgjegjshëm. INPO pas monitorimit të ligjshmërisë së anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit përfundon që Komuna e Prishtinës në mënyrë krejtësisht të ligjshme e ka anuluar aktivitetin pasi që nga dhjetë (10) OE-të ofertues, gjashtë (6) prej tyre kanë ofertuar me çmim më të lartë se vlera e parashikuar nga AK, tre (3) prej tyre kanë ofruar çmime jo normalisht të ulëta, ndërsa një OE gabimet aritmetikore i ka pasur mbi vlerën 2%.⁶² Andaj, Komuna e Prishtinës edhe këtë aktivitet të prokurimit e ka anuluar në përputhje me kërkesat ligjore.⁶³

8.15. Komuna e Prizrenit

Komuna e Prizrenit nga njëmbëdhjetë (11) aktivitete të prokurimit sa kishte anuluar gjatë vitit 2020, këtë numër e ka rritur në njëzetë (20) gjatë vitit 2021. Aktivitetet e përzgjedhura për monitorim të ligjshmërisë së anulimit mbajnë titullin “Organizimi i trajnimeve për zejet e filigranit, vekut, plisit, frizer, dizajn grafik, marketing, gastronomi dhe qepje” dhe “Furnizim me inventar shkollor për nevojat e institucioneve arsimore të Komunës së Prizrenit”.

Aktivitetin “Organizimi i trajnimeve për zejet e filigranit, vekut, plisit, frizer, dizajn grafik, marketing, gastronomi dhe qepje”, Komuna e Prizrenit e ka anuluar me arsyen se nuk ka ofertuar asnjë OE.⁶⁴ Edhe pas monitorimit të INPO-s rezulton se AK këtë aktivitet të prokurimit e ka anuluar në përputhje me kërkesat ligjore sepse nuk ka pranuar asnjë ofertë.

Aktiviteti “Furnizim me inventar shkollor për nevojat e institucioneve arsimore të Komunës së Prizrenit”, është anuluar me arsyen se të gjithë OE-të ofertues kanë qenë të papërgjegjshëm.⁶⁵ Pas monitorimit të INPO-s rezulton se edhe ky aktivitet është anuluar me të drejtë nga Komuna e Prizrenit sepse të dy (2) OE-të ofertues kishin qenë të papërgjegjshëm, njëri nga ta kishte ofertuar me çmim më të lartë se vlera e parashikuar e aktivitetit, ndërsa OE tjetër nuk kishte prezantuar mostrat sipas kërkesave të AK-së.

Se AK ka pasur të dejtë në anulimin e aktivitetit e dëshmon edhe raporti i ekspertit shqyrtues të OShP-së i cili duke vepruar sipas ankesës kishte rekomanduar që të vërtetohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit.⁶⁶

⁶² Për më shumë shih njoftimin mbi vendimin e AK-së, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1719022.

⁶³ Shih dispozitat ligjore lidhur me anulimin e aktivitetit të prokurimit, neni 44 i RrUOPP, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

⁶⁴ Shih procesverbalin e hapjes https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1319782.

⁶⁵ Për më shumë shih njoftimin mbi vendimin e AK-së, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1790291.

⁶⁶ Shih raportin e ekspertit Nr. 645/21, i datës 13.09.2021, <https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Search>.

8.16. Komuna e Rahovecit

Gjatë vitit 2021, Komuna e Rahovecit ka anuluar gjithsej katër (4) aktivitete të prokurimit, ndërsa aktivitetet e përzgjedhura për monitorim janë aktiviteti me titull “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit LOT XVII, XVIII dhe XX” dhe aktiviteti “Ndërtimi i sheshit qendror të qytetit”.

Aktivitetin “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit LOT XVII, XVIII dhe XX”, komuna e ka anuluar për shkak se Lot XVII ka qenë oferta e papërgjegjshme, ndërsa për Lot XVII dhe XX nuk ka pranuar asnjë ofertë.⁶⁷ Pas monitorimit të INPO-s del që Komuna e Rahovecit me të drejtë i ka anuluar këto lote, sidoqoftë i tërë ky aktivitet i prokurimit është i kontestueshëm në aspekt ligjor, posaçërisht duke marrë parasysh edhe njoftimin e KRPP-së Nr.06/2021 të datës 02.02.2021, ku kërkohet nga të gjitha AK-të që të mos e përdorin rregullat për shërbime të veçanta për pozita të rregullta të punës.⁶⁸ Pra, rregullat për konsulent mund të aplikohen vetëm për shërbime të cilat nuk mund të merren nëpërmjet procedurave të rregullta rekrutuese sipas Ligjit Nr.06 L-144 për Zyrtarët Publik.

Aktivitetin “Ndërtimi i sheshit qendror të qytetit”, Komuna e Rahovecit e ka anuluar me arsyen se ka ndodhur “Lëshim në paramasën e korrigjuar nga njësia kërkuese duke mos e bashkangjitur mirëmbajtjen tre (3) vjeçare të projektit e cila ka një kosto të konsiderueshme, gjithashtu nuk gjen mbështetje tek formula e poentimit tek dosje e tenderit”.⁶⁹ INPO këtë vendim për anulim të aktivitetit të prokurimit e ka monitoruar paraprakisht ku për të njëjtin rast ka reaguar në drejtim të Komunës së Rahovecit duke e konsideruar anulimin në kundërshtim me kërkesat ligjore.

Përveç se anulimi është në kundërshtim me ligjin, edhe arsyet e anulimit të tenderit janë të pa qëndrueshme, përkatësisht arsyeja “Lëshim në paramasë nga njësia kërkuese duke mos e bashkangjitur mirëmbajtjen tre (3) vjeçare të projektit e cila ka një kosto të konsiderueshme”, nuk qëndron. Kjo për faktin se në Aneks 6 në Dosjen e Tenderit është sqaruar edhe kjo çështje për të gjithë OE-të. Pra, në Dosje të Tenderit në mënyrë të qartë shkruan se “Operimigarancioni, mirëmbajtja pas pranimit teknik i ka 20% të pikëve”.⁷⁰ Andaj, Komuna e Rahovecit pasi që ka parë renditjen e OE-ve dhe duke vepruar në kundërshtim me ligjin ka anuluar këtë aktivitet.

Tutje, OE “ALFA. I SH.P.K.” i cili ishte me çmimin më të lirë në këtë aktivitet, brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, ndërsa Komuna e Rahovecit kundërligjshëm kërkesën e hedhë poshtë si të pasafatshme, duke pretenduar se kanë kaluar tetë (8) ditë nga afati pesë (5) ditë i lejuar me Ligj. Edhe hedhja poshtë e ankesës si e pasafatshme paraqet një shkëlqje tjetër sepse në bazë të nenit 5, paragrafi I të LPP-së “Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune”, ndërsa në bazë të nenit 4, paragrafi 2 të Formularit F03

⁶⁷ Për më shumë shih njoftimin mbi vendimin e AK-së, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1329857.

⁶⁸ Shih njoftimin e KRPP-së, <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/Documents/Lajmet%20levizese/alb/464/Njoftim%20-%20sherbimet%20e%20veqanta.pdf>.

⁶⁹ Për më shumë shih njoftimin mbi vendimin e AK-së, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1646163.

⁷⁰ Po aty, Dosja e Tenderit, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1646163..

Rregullat për parashtrim të ankesave taksativisht thuhet se “Data e njoftimit të vendimit për anulim është “dita 0” e 5 ditëve të obligueshme të periudhës “në pezullim”.⁷¹ Pra, njoftimi për anulim është publikuar më 25.10.2021, e cila ka qenë dita zero (0), ndërsa dita pesë (5) i bie të jetë dita e shtunë, duke u bazuar në nenin 5, paragrafi 2 të LPP-së, dita e fundit duhet t’i bie ditë pune, në këtë rast dita e fundit i bie dita e hënë datë 01.11.2021, datë në të cilën edhe ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim OE “ALFA. I SH.P.K.”, saktësisht në orën 15:07. Pra, edhe në këtë rast kemi të bëjmë me anulim të kundërligjshëm të aktivitetit të prokurimit.

8.17. Komuna e Suharekës

Komuna e Suharekës gjatë vitit 2021 ka anuluar gjithsej gjashtëmbëdhjetë (16) aktivitete të prokurimit, apo tetë (8) më shumë se sa në vitin 2020. Aktivitetet e përzgjedhura për monitorim të ligjshmërisë së anulimit janë aktiviteti “Furnizim me oksigjen medicinal për QKMF në Suharekë” dhe aktiviteti “Shërbimet e transportit sipas vitit kalendarik 2022 - LOT 7”.

Aktivitetin “Furnizim me oksigjen medicinal për QKMF në Suharekë”, Komuna e Suharekës e ka anuluar me arsyen se nuk ka ofertuar asnjë OE. INPO ka monitoruar ligjshmërinë e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit dhe të dhënat rezultojnë se Komuna e Suharekës me të drejtë ka anuluar këtë aktivitet pasi që nuk ka pranuar asnjë ofertë.⁷² Sidoqoftë, komuna duhet t’i analizoj shkaktarët që kanë ndikuar që për këtë aktivitet të mos ketë asnjë ofertë, e gjithë kjo në mënyrë që AK të mos përballet me një situatë të tillë në të ardhmen.

Aktiviteti “Shërbimet e transportit sipas vitit kalendarik 2022 - LOT 7”, është anuluar me arsyen se AK nuk ka pranuar asnjë ofertë të përgjegjshme.⁷³ Pas monitorimit të INPO-s vërtetohet se Komuna e Suharekës edhe këtë aktivitet të prokurimit e ka anuluar në përputhje me kërkesat ligjore, pasi që të dy OE-të që kanë ofertuar për këtë lot kanë qenë të papërgjegjshëm, madje njëri nga ta kishte ofruar dëshmi të rreme, gjë e cila ka ndikuar që AK ta konfiskoj sigurinë e tenderit dhe të paraqes kërkesë në OShP për diskualifikim të OE-së sipas nenit 99 të LPP-së.⁷⁴

8.18. Komuna e Shtimes

Komuna e Shtimes gjatë vitit 2021 ka anuluar gjithsej pesë (5) aktivitete të prokurimit por të cilat gjatë po të njëjtit vit i ka të ri-tenderuar dhe tanimë janë nënshkruar kontratat. Meqë si aktivitete të anuluar në këtë hulumtim janë konsideruar vetëm aktivitetet të cilat janë anuluar dhe të cilat nuk janë ri-tenderuar, apo edhe ri-tenderimet kanë rezultuar të anulohen, konsiderohet që kjo komunë gjatë vitit 2021 nuk ka aktivitete të anuluar.

⁷¹ Shih nenin 5, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, <https://gzk.rksgov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>, shih gjithashtu Formularin F03, Rregullat për parashtrimin e ankesave, <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=233>.

⁷² Për më shumë shih procesverbalin e hapjes së tenderëve dhe njoftimin mbi vendimin e AK-së, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1292769.

⁷³ Për më shumë shih njoftimin mbi vendimin e AK-së, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1773948.

⁷⁴ Shih nenin 99, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, <https://gzk.rksgov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>.

8.19. Komuna e Vitisë

Komuna e Vitisë gjatë vitit 2021 ka anuluar tri (3) aktivitete të prokurimit, ndërsa aktivitetet e përzgjedhura për monitorim janë aktiviteti “Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike në Komunën e Vitisë” dhe aktiviteti “Renovimi i ambulantave”.

Aktiviteti “Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike në Komunën e Vitisë”, është anuluar me arsyen se AK nuk ka pranuar oferta të përgjegjshme.⁷⁵ INPO pas monitorimit të ligjshmërisë së anulimit, përfundon se OE i vetëm ofertues në këtë aktivitet nuk ka qenë i përgjegjshëm sepse nuk ka përmblusur të gjitha kërkesat lidhur me kapacitetin financiar dhe teknik/profesional. Andaj, Komuna e Vitisë në përputhje me kërkesat ligjore ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit.

Aktivitetin “Renovimi i ambulantave”, Komuna e Vitisë e ka anuluar me arsyen se ky aktivitet i prokurimit që nga data 15 nëntor 2021 është i pezulluar për shkak se një OE ka parashtruar ankesë në OShP dhe për shkak të mungesës së vendimmarrjes në këtë institucion, më 8 shkurt 2021, me anë të një konkluzioni ka vendosur ta anuloj këtë aktivitet të prokurimit.⁷⁶ INPO vlerëson se duke pasur parasysh që raporti i ekspertit shqyrtues të autorizuar nga OShP, ka rekomanduar që lënda të kthehet në ri-vlerësim, Komuna e Vitisë ka mundur që të pajtohet me atë rekomandim dhe lëndën ta kthej në ri-vlerësim, në mënyrë që të shmanget anulimi i aktivitetit.⁷⁷ Sidoqoftë, mungesa e vendimmarrjes në OShP nuk është me fajin e AK-ve dhe në një rrethanë se a të pritët pa kufi konstituimi i Bordit të OShP-së apo të anulohet aktiviteti i prokurimit opsioni i dytë do të ishte më i pranueshëm nëse AK është e vendosur se nuk ka gabuar proceduralisht.⁷⁸

8.20. Komuna e Vushtrrisë

Komuna e Vushtrrisë gjatë vitit 2021 ka anuluar gjithsej dymbëdhjetë (12) aktivitete të prokurimit, ndërsa aktivitetet e monitoruara janë aktiviteti me titull “Blerja e shërbimeve të konsulencës individuale për menaxhimin e kontratave për nevojat e Komunës së Vushtrrisë” dhe aktivitetit “Furnizimi me kositëse të barit”.

Aktiviteti “Blerja e shërbimeve të konsulencës individuale për menaxhimin e kontratave për nevojat e Komunës së Vushtrrisë”, është anuluar me arsyen se “AK më 28.09.2021 ka pranuar një kërkesë për rishqyrtimin e kërkesave të vendosura në dosjen e tenderit, me të pranuar kërkesën për ri-shqyrtim, AK në harmoni me dispozitat ligjore për prokurim publik ka ngritur në platformë vendimin mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit. AK nuk ka publikuar njoftimin për korigjimin e procedurës së prokurimit me të cilin do të bënte shtyrjen e afatit kohor për dorëzimin e ofertave pasi që afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data 04.10.2021 ,ku deri me këtë datë AK ka pranuar një ofertë dhe të cilën nuk e ka hapur për arsye se ngritja e pezullimit të aktivitetit ka mundur të jetë njëri ndër shkaktarët i cili ka

⁷⁵ Për më shumë shih njoftimin mbi vendimin e AK-së, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1643344.

⁷⁶ Për më shumë shih konkluzionin e AK-së, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1741776.

⁷⁷ Shih raportin e ekspertit shqyrtues, i datës 30.11.2021, <https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Search>.

⁷⁸ Shih gjithashtu raportin “OSHP peng i politikës”, <http://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2022/02/Raport-OSHP-peng-i-politik%C3%ABs-I.pdf>.

ndikuar tek OE-të e interesuar. Me qëllim të trajtimit të barabartë të OE-ve, AK merr vendim që të bëj anulimin e këtij aktiviteti dhe njëkohësisht sa ma shpejtë që është e mundur do të bëj publikimin e ri-tenderimit për të njëjtin aktivitet të prokurimit”.⁷⁹ Pra, bëhet fjalë për lëshim procedural të AK-së dhe në raste të tilla anulimi i aktivitetit të prokurimit nuk është i bazuar në dispozita ligjore dhe rrjedhimisht AK-në nuk e mbrojnë ndaj pretendimeve për shkaktim të dëmit nga OE që ka ofertuar në këtë aktivitet. Gjithashtu, hulumtimet e INPO-s, vërtetojnë se gjatë vitit 2021 ky aktivitet është ri-tenderuar, mirëpo përsëri është anuluar për shkak të neglizhencës së AK-së që brenda afateve kohore ta bëjë vlerësimin e ofertave.⁸⁰

Aktivitetin “Furnizimi me kositëse të barit”, Komuna e Vushtrrisë e ka anuluar me arsyen se “Nga data e hapjes së ofertave për aktivitetin e prokurimit në fjalë kanë kaluar mbi 45 ditë. Rrjedhimisht ka skaduar dhe kohëzgjatja e vlefshmërisë të ofertave. Andaj, marrë parasysh situatën e krijuar pas hapjes së ofertave të pranuar, faktit se një kërkesë për zgjatje të vlefshmërisë së tenderit në këtë fazë nuk është e lejuar të bëhet, vazhdimi i mëtejme me aktivitetin e prokurimit në fjalë procesin do ta bënte të paefektshëm, jo të plotë, ndërsa, lidhja eventualisht e kontratës me OE, bazuar në nenin 62 paragrafi I pika I të LPP-së, lidhur me nenin 44.5 pika (ix) do të përbënte shkelje ligji që do të ndodhë dhe nuk do të mundë të parandalohet përmes një ndryshimi, andaj AK ka vendosur ta anuloj këtë aktivitet të prokurimit”.⁸¹ Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një jo profesionalizëm të AK-së sa i përket udhëheqjes së procedurave të prokurimit. Konkretisht pasi që është parë se cilët OE kanë ofertuar, procesi i vlerësimit ka zgjatur pa kufi, madje duke mos kërkuar as zgjatje të validitetit të tenderit dhe me vetëdije të plotë AK ka sjellë vetën në atë situatë që aktiviteti duhet të anulohet.

Ky jo profesionalizëm, AK-në e bënë përgjegjëse ndaj pretendimeve të OE-ve lidhur me shkaktimin e dëmit si pasojë e anulimit të aktivitetit të prokurimit dhe përveç kësaj, si pasojë e jo profesionalizmit AK ka mbetur pa furnizimin me kositëse të barit gjatë vitit 2021.⁸²

9. Komunitat që kanë anuluar aktivitete të prokurimit në mënyrë të kundërligjshme

Ashtu siç është shtjelluar tek baza ligjore për anulimin e aktiviteteve të prokurimit, është e qartë se procedurat e prokurimit lidhur me një aktivitet të caktuar mund të ndërpriten vetëm kur shkaktohet një rrethanë e paraparë me dispozita ligjore.⁸³ Në raste kur anulimi nuk bazohet në

⁷⁹ Për më shumë, shih Formularin B10, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1605944.

⁸⁰ Shih aktivitetin e ri-tenderuar dhe të anuluar, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1732606.

⁸¹ Për më shumë, shih Formularin B10, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1736196.

⁸² Shih gjithashtu nenin 44.5 lidhur me nenin 44.8 të RrUOPP-it, ku janë të shpjeguara rastet se kur mund të anulohet aktiviteti pas hapjes së ofertave dhe cilat janë pasojat e anulimit të kundërligjshëm, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

⁸³ Shin neni 62 të LPP-së <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>, lidhur me nenin 44 të RrUOPP, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

dispozita ligjore, përveç se kemi të bëjmë me një veprim të kundërligjshëm të AK-së, në të njëjtën kohë kemi të bëjmë me shkaktim të dëmit ndaj OE-ve të cilët kanë marr pjesë në aktivitetin i cili është anuluar.

Nga monitorimi i aktivitetit të parë dhe të fundit të anuluar nga komunat gjatë vitit 2021, INPO ka hasur në raste ku AK-të kanë anuluar aktivitete pa u bazuar në dispozita ligjore. Këto gjetje i gjeni në tabelën më poshtë.

Komunat të cilat kanë anuluar aktivitete të prokurimit në kundërshtim me dispozitat ligjore		
Komuna	Titulli i aktivitetit të anuluar në mënyrë të kundërligjshme	Numri i prokurimit
Ferizaj	Asfaltimi i rrugëve dhe trotuarëve në fsh. Varosh, Fshati i Vjetër, Bibaj dhe Nikadin - Projekt tre vjeçar	656-21-1161-5-1-1
	Furnizimi i fermerëve me koshere të bletëve	656-21-2137-1-2-1
Glllogoc	Furnizim me artikuj, 1 material elektrik, veglari dhe llaqe, 2. Artikuj të sanitarisë dhe 3. Artikuj bujqësorë - Për nevojat e institucioneve komunale, Administratës, arsimit dhe shëndetësisë së Drenasit	611-21-1216-1-1-1
Gjilan	Pastrimi i objekteve komunale dhe shëndetësore në Komunën e Gjilanit	651-21-9661-2-1-1
Leposaviq	Përgatitja e dokumentacionit teknik të projektit	641-21-8005-2-2-1
Mitrovicë e Veriut	Prokurimi i pajisjeve digjitale (tabletëve) për nevojat e shkollave të mesme	647-21-1908-1-2-1
Pejë	Blerja e një autoambulance për urgjencën e qytetit	635-21-925-1-2-1
Rahovec	Ndërtimi i sheshit qendror të qytetit	623-21-4129-5-1-1
Vushtrri	Blerja e shërbimeve të konsulencës individuale për menaxhimin e kontratave për nevojat e Komunës së Vushtrrisë	644-21-6416-2-2-1
	Furnizimi me koshtëse të barit	644-21-7201-1-3-6

Tabela 7: Komunat të cilat kanë anuluar aktivitete të prokurimit në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Nga monitorimi i dy (2) aktiviteteve të anuluar gjatë vitit 2021, konkretisht aktiviteti i parë dhe fundit, vërtetohet se në mënyrë të kundërligjshme janë anuluar gjithsej dhjetë (10) aktivitete në tetë (8) komuna. Madje, në Komunën e Ferizajt dhe Vushtrrisë rezultojnë që të dy aktivitetet e monitoruara kanë qenë të anuluar në mënyrë të kundërligjshme.

INPO ka monitoruar ligjshmërinë e aktiviteteve të anuluar në këto njëzetë (20) komuna edhe gjatë vitit 2020. Andaj, është e rëndësishme të bëhen krahasime në mes të ligjshmërisë së anulimit të aktiviteteve të prokurimit gjatë vitit 2020 dhe 2021. Në tabelën më poshtë i gjeni të dhënat lidhur me këtë krahasim.

Krahasimi i komunave që kanë pasur aktivitete të anuluar në mënyrë të kundërligjshme gjatë vitit 2020 dhe 2021			
Nr.	Komuna	Aktivitete të anuluar në mënyrë të kundërligjshme gjatë vitit 2020 ⁸⁴	Aktivitete të anuluar në mënyrë të kundërligjshme gjatë vitit 2021
1	Deçan	√	Nuk ka aktivitete të anuluar
2	Dragash	√	x
3	Ferizaj	√	√
4	Glllogoc	x	√
5	Gjakovë	x	x

⁸⁴ Burimi: Raporti "(Pa) ligjshmëria e tenderëve të anuluar", <http://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2021/10/Raport-Pa-Ligjshm%C3%ABria-e-tender%C3%ABve-t%C3%AB-anuluar.pdf>.

6	Gjilan	√	√
7	Kaçanik	x	x
8	Kamenicë	x	x
9	Klinë	x	x
10	Leposaviq	√	√
11	Mitrovicë e Veriut	√	√
12	Pejë	√	√
13	Podujevë	x	x
14	Prishtinë	x	x
15	Prizren	√	x
16	Rahovec	Nuk ka aktivitete të anuluar	√
17	Suharekë	√	x
18	Shtime	√	Nuk ka aktivitete të anuluar
19	Viti	√	x
20	Vushtrri	√	√

Tabela 8: Krahasimi i komunave që kanë pasur aktivitete të anuluar në mënyrë të kundërligjshme gjatë vitit 2020 dhe 2021.

Të dhënat në tabelë dëshmojnë se për dallim që gjatë vitit 2020 janë identifikuar dymbëdhjetë (12) komuna me anulime të kundërligjshme, ky numër gjatë vitit 2021 është tetë (8). Përderisa Komuna e Deçanit dhe Komuna e Shtimes gjatë vitit 2020 kanë anuluar aktivitete në mënyrë të kundërligjshme, ato gjatë vitit 2021 nuk kanë asnjë aktivitet të anuluar përfundimisht, ndërsa komunat Dragash, Prizren, Suharekë dhe Viti të cilat gjatë vitit 2020 kanë anuluar aktivitete në mënyrë të kundërligjshme, të njëjtat gjatë vitit 2021 aktivitetet e monitoruara i kanë anuluar konformë dispozitave ligjore.

Komuna e Glllogocit përkundër që gjatë vitit 2020 aktivitetet e monitoruara i ka pasur të anuluar në përputhje me dispozitat ligjore, ajo gjatë vitit 2021 rezulton se ka aktivitete të anuluar në kundërshtim me dispozitat ligjore. Të dhënat në tabelë gjithashtu tregojnë se Komuna e Ferizajt, Gjilanit, Leposaviqit, Mitrovicës së Veriut, Pejës dhe Vushtrrisë, sikurse gjatë vitit 2020 edhe gjatë vitit 2021 kanë vazhduar me anulime të aktiviteteve në kundërshtim me ligjin, ndërsa komunat Gjakovë, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Podujevë dhe Prishtinë vazhdojnë shembullin e mirë, ku sikurse gjatë vitit 2020 edhe gjatë vitit 2021 nga aktivitetet e monitoruara rezulton se anulimi ka qenë në bazë të kërkesave ligjore.

10. Roli i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik në mbikëqyrjen e ligjshmërisë së aktiviteteve të anuluar

Në kuadër të kompetencave mbikëqyrëse, KRPP monitoron edhe zhvillimin e procedurave të prokurimit nga ana e AK-ve, përkatësisht ofron “opinione autoriteteve kontraktuese në lidhje me vendimet e tyre, veprat apo anashkalimet gjatë aktiviteteve të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave”.⁸⁵

Në kuadër të kompetencave të saj, KRPP çdo vit kërkon nga AK-të raportin vjetor të kontratave publike të nënshkruara gjatë vitit përkatës, ndërsa për kontaktat e nënshkruara gjatë vitit 2021 këtë raport e ka kërkuar më 13 janar 2022, dhe AK-të të njëjtin është dashur ta dorëzonë më së

⁸⁵ Shih, neni 87, paragrafi 2, nënparagraf 2.2 i Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

largu deri më 4 shkurt 2022.⁸⁶ Për dallim nga ky vit, gjatë viteve të kaluara KPRR, sa i përket aktiviteteve të anuluar, çdo vit ka kërkuar nga AK-të që të dorëzojnë një listë të aktiviteteve të anuluar gjatë vitit përkatës sipas vlerës së parashikuar të tyre.⁸⁷

Madje, gjatë vitit të kaluar INPO kishte evidentuar të dhëna jo të sakta sa u përket aktiviteteve të anuluar të cilat janë deklaruar në KRPP. INPO ka kërkuar nga AK-të, listën me të gjitha aktivitetet e anuluar gjatë vitit 2020, pra listën e njëjtë të cilën AK-të e kanë pasur obligim ta dërgojnë në KRPP, dhe të gjeturat rezultojnë se të dhënat nuk janë në të gjitha rastet të sakta, përkatësisht nuk paraqesin një pasqyrë reale të aktiviteteve të anuluar.⁸⁸

Tutje, duke pasur parasysh rolin e këtij institucioni, INPO më 15 qershor 2021 lidhur me këtë çështje ka zhvilluar intervistë me kryetarin e Bordit të KRPP-së z. Osman Vishaj.

Fillimisht z. Vishaj është pyetur lidhur me atë se si KRPP-ja i qaset monitorimit të aktiviteteve të prokurimit, me theks të veçantë aktiviteteve të anuluar. Përgjigja ka qenë se prioritet kanë kryesisht aktivitetet me vlerë të madhe të parashikuar, ndërsa sa i përket aktiviteteve të anuluar vetëm gjatë vitit 2020, potencon se janë monitoruar mbi katërqind (400) aktivitete. Lidhur me gjetjet e INPO-s se shumë aktivitete anulohen pa ndonjë bazë ligjore, z. Vishaj deklaroi se në rastet kur aktivitetet e anuluar të cilat nuk kanë mbështetje ligjore, e të cilat vërehen nga KRPP-ja, ky institucion lëshon opinion në drejtim të AK-së dhe kërkon që ajo shkelje të evitohet.

Gjithashtu, thekson se gjetjet e KRPP-së mbesin në cilësinë e një opinioni apo rekomandimi, mirëpo zakonisht merren parasysh nga ana e AK-ve. Sidoqoftë, KRPP nuk ka kompetencë dhe as autorizim që ta anuloj një aktivitet të prokurimit. Lidhur me atë se të dhënat që dërgojnë AK-të në KRPP nuk janë një pasqyrë e saktë dhe reale e aktiviteteve të anuluar, z. Vishaj potencon se kjo mbetet në përgjegjësinë profesionale të AK-ve.

Kryetari i Bordit të KRPP-së, gjithashtu potencoi se KRPP kryen monitorimin në bazë të detyrës zyrtare, mirëpo gjithashtu monitorimin e zhvillon edhe në rast kur njoftohet nga palët e treta, e këtu posaçërisht bëjnë pjesë OE-të, Organizatat e Shoqërisë Civile (tutje OSHC) etj.

Pra, KRPP-së me LPP i njihet kompetenca mbikëqyrëse, mirëpo ndërhyja e saj në procedurat që i zhvillojnë AK-të praktikisht është e pamundur. Në fakt KRPP mund të lëshoj opinion në drejtim të AK-së, dhe mbetet në diskrecion të AK-së se a dëshiron ta zbatoj opinionin apo jo.

I I. Roli i Organit Shqyrtues të Prokurimit në anulimin e aktiviteteve të prokurimit

OSHP është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. OSHP përbëhet nga kryetari dhe katër (4) anëtarë të cilët i voton Kuvendi për një mandat pesë (5) vjeçar pa të drejtë riemërimi.⁸⁹ Kompetencat kryesore të OSHP-së janë: Shqyrtimi i ankesave në shkallë të dytë të paraqitura nga OE-të, pastaj në bazë të një kërkesë me shkrim nga AK-të në lidhje me

⁸⁶ Për më shumë shih njoftimin Nr. 01/2022, I dates 13.01.2022, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Lajmet%20levizese/alb/493/Njoftim%20-%20raporti%20vjetor.pdf>.

⁸⁷ Shih njoftimin e KRPP-së, i datës 15.01.2021, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Lajmet%20levizese/alb/447/Njoftim%20per%20AK%2015012021.pdf>.

⁸⁸ Burimi: Të dhënat e dërguara nga AK-të nëpërmjet kërkesës për qasje në dokument publike.

⁸⁹ Për më shumë shih nenin 100 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>.

paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga OE-të, OShP është e obliguar dhe ka autoritetin që kërkesën e tillë ta shqyrtojë dhe të diskualifikoj OE-në nga pjesëmarrja në procedura të prokurimit publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare, rekomandimin që ti anulohet certifikata profesionale një zyrtari të prokurimit e kështu me radhë. Është e rëndësishme që vendimet e OShP-së janë të apelueshme, përkatësisht të njëjtat mund të kontestohen në procedurë administrative në gjykatat e Republikës së Kosovës.

Gjatë vitit 2021 dhe 2022 është paraqitur një fenomen tjetër kur AK-të anulojnë aktivitetet të prokurimit duke u bazuar në mungesën e Bordit të OShP-së për gati pesëmbëdhjetë (15) muaj, dhe si arsyetim i vendimmarrjes së vonuar shumë AK kanë zhgjedhë të anulojnë në tërësi aktivitetet që kanë qenë në proces të ankimimit në OShP.⁹⁰

INPO gjithashtu, gjatë hulumtimit të aktiviteteve të anulara gjatë vitit 2020 kishte gjetur se një numër i konsideruar i aktiviteteve të anuluar vije si pasojë e vendimit të OShP-së, të cilat vendime e detyrojnë një anulim të tillë. Këto vendime për anulim të aktiviteteve të prokurimit kishin ardhur ose për mos përfillje të vendimeve të këtij institucioni, ose për shkak të shkeljeve të pa riparueshme ligjore të shkaktuara nga AK-të.

Madje për këtë çështje INPO më 10 qershor 2021 ka zhvilluar intervistë me kryesuesin e sekretariatit të OShP-së z. Ardian Behra, lidhur me gjetjet e raportit. Fillimisht z. Behra ka potencuar se vendimet për anulim që vijnë nga OShP kanë të bëjnë me ato aktivitete ku shkeljet e dispozitave të LPP-së janë të pa riparueshme, do të thotë nuk ka hapësirë për rivlerësim por aktiviteti duhet të anulohet. Gjatë vitit 2020 thotë se OShP me anë të vendimeve të saj ka anuluar gjithsej gjashtëdhjetetë (63) aktivitete. Meqë gjatë hulumtimit të INPO-s është vënë në pah fenomenin e mosrespektimit të vendimeve të OShP-së, z. Behra potencon se OShP nuk e ka një mekanizëm të monitorimit të zbatimit të vendimeve të saj. Kjo për faktin e mungesave në staf, ndërsa për mos zbatim kryesisht njoftohen nga palët e treta, përkatësisht OE-të, OJQ-të e kështu me radhë.⁹¹

⁹⁰ Për më shumë shih raportin e INPO-s, “OSHP peng i politikës”, <http://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2022/02/Raport-OSHP-peng-i-politik%C3%ABs-I.pdf>.

⁹¹ Për më shumë, shih raportin e INPO-s, “(Pa) ligjshmëria e tenderëve të anuluar, Prishtinë 2021”, <http://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2021/10/Raport-Pa-Ligjshm%C3%ABria-e-tender%C3%ABve-t%C3%AB-anuluar.pdf>.

12. Gjetjet kryesore

- Gjatë vitit 2021 komunat kanë anuluar njëqind e dyzet (140) aktivitete të prokurimit, vlera totale aktiviteteve të anuluar është 21,285,876.06 euro, apo 15.41% e komplet vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2021 në njëzetë (20) komuna të Republikës së Kosovës.
- Komunat me më së shumti aktivitete të anuluar janë Komuna e Prizrenit me njëzetë (20) aktivitete të anuluar, e pasuar nga Komuna e Ferizajt dhe Suharekës me nga gjashtëmbëdhjetë (16) aktivitete të anuluar.
- Komunat me më së paku aktivitete të anuluar gjatë vitit 2021 janë Komuna e Leposaviqit me vetëm një (1) aktivitet të anuluar dhe Komuna e Deçanit dhe Shtimes me asnjë aktivitet të anuluar.
- Gjatë vitit 2021, mesatarisht në çdo komunë përfundimisht janë anuluar shtatë (7) aktivitete të prokurimit.
- Krahasuar me vitin 2020, komunat gjatë vitit 2021 kanë anuluar dyzet e pesë (45) aktivitete më shumë, apo shprehur në përqindje 47.3%, kurse vlera e aktiviteteve të anuluar është për 7,009,178.50 euro më e lartë se në vitin 2020.
- Nga njëzetë (20) komunat e monitoruara, katërmëdhjetë (14), apo 70% prej tyre nuk kanë publikuar Formularin B58 - Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues, për aktivitetet e anuluar, ndërsa në një rast Komuna e Suharekës nuk ka publikuar fare Formularin B10 - Njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit.
- Nga njëqind e dyzet (140) aktivitete të anuluar gjatë vitit 2021, gjashtëmbëdhjetë (16) prej tyre apo 11.42% janë anuluar para hapjes së ofertave, kurse njëqind e njëzet e katër (124) apo 88.58%, janë anuluar pas hapjes së ofertave.
- Përveç arsyeve tjera ligjore, ZPP-të deklarojnë se anulimet e aktiviteteve të prokurimit ndodhin edhe për faktin e gabimeve në specifika të tenderit nga njësitë kërkuese.
- Vetëm tridhjetë e tre (33) nga njëqind e dyzet (140) aktivitetet e anuluar kanë qenë të planifikuara, pesëdhjetë e një (51) aktivitete të anuluar kanë qenë të planifikuara, mirëpo vlera e parashikuar gjatë inicimit nuk ka qenë e njëjtë si në plan të prokurimit, ndërsa pesëdhjetë e gjashtë (56) aktivitete të anuluar fare nuk kanë qenë të planifikuara.
- Nga monitorimi i dy (2) aktiviteteve të anuluar gjatë vitit 2021, konkretisht aktiviteti i parë dhe i fundit i iniciuar gjatë vitit 2021 dhe i anuluar, në mënyrë të kundërligjshme janë anuluar gjithsej dhjetë (10) aktivitete në tetë (8) komuna. Madje, në Komunën e Ferizajt

dhe Vushtrrisë rezulton që të dy aktivitetet e monitoruara kanë qenë të anuluar në mënyrë të kundërligjshme.

- Komunat gjatë vitit 2021 kanë shënuar progres sa i përket ligjshmërisë së anulimit të aktiviteteve të prokurimit, përderisa që gjatë vitit 2020 janë identifikuar dymbëdhjetë (12) komuna me anulime të kundërligjshme, ky numër gjatë vitit 2021 është tetë (8).
- KRPP nuk ka fuqi ligjore që të kërkoj anulimin e aktivitetit të prokurimit, mirëpo gjetjet e këtij institucioni shndërrohen në opinione në drejtim të AK –ve të cilat zakonisht gjejnë zbatim.
- Jo të gjitha vendimet e OShP-së gjejnë zbatim dhe OShP nuk ka një mekanizëm i cili përcjellë zbatueshmërinë e vendimeve të saj.

13. Rekomandime

- Komunat të kujdesen që numri i aktiviteteve të anuluar të jetë sa më i vogël, ndërsa atëherë kur anulimi i aktivitetit është i pa shmangshëm i njëjti të jetë i bazuar në ligj.
- Komuna e Ferizajt, Glllogocit, Gjakovës, Gjilanit, Kaçanikut, Kamenicës, Leposaviqit, Pejës, Prishtinës, Prizrenit, Rahovecit, Suharekës, Vitisë dhe Vushtrrisë, të sigurohen që publikojnë Formularin B10 - Njoftimin mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe Formulari B58 - Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues pas çdo anulimi të aktiviteti të prokurimit.
- Komuna e Prishtinës, Suharekës dhe Vitisë të sigurohen se plotësojnë të gjitha informatat e nevojshme në Formularin B10 Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit.
- Komuna e Ferizajt, Gjilanit, Kamenicës, Prishtinës, Prizrenit, Suharekës, Vitisë dhe Vushtrrisë të kujdesen që në njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit të vendosin të dhëna të sakta.
- Njësitë kërkuese brenda komunave të sigurohen që hartojnë specifikat teknike në përputhje me nevojat dhe natyrën e furnizimit, shërbimit apo punës, në të kundërtën anulimi i aktivitetit i bazuar në këto arsye është në kundërshtim me dispozitat ligjore.
- Përjashtuar Komunën e Deçanit, Leposaviqit, Mitrovicës së Veriut dhe Shtimes, komunat tjera të kujdesen që aktivitetet e iniciuara t'i kenë në planin përfundimtar të prokurimit.
- Komuna e Ferizajt, Glllogocit, Gjilanit, Leposaviqit, Mitrovicës së Veriut, Pejës, Rahovecit dhe Vushtrrisë të sigurohen që në të ardhmen të mos anulojnë aktivitete të prokurimit në kundërshtim me kërkesat ligjore.
- Komunat t'i adresojnë shkaktarët kryesor të anulimit të aktiviteteve të prokurimit, posaçërisht rastet kur mungojnë ofertat dhe rastet kur të gjithë OE-të janë të papërgjegjshëm, në mënyrë që këta shkaktarë të jenë sa më të paktë në të ardhmen.
- KRPP të shtoj kapacitetet monitoruese në mënyrë që të reduktohet anulimi i aktiviteteve të prokurimit pa bazë ligjore.
- OShP të rrisë kapacitetet në mënyrë që të sigurohet se të gjitha vendimet që ky organ nxjerr, zbatohen nga ana e AK-ve.

14. ANEKS I - Lista e aktiviteteve të anuluar në njëzetë (20) komuna

LISTA E AKTIVITETEVE TË ANULUARA NË NJËZETË (20) KOMUNA			
KOMUNA E DEÇANIT			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar ⁹²	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1	Nuk ka aktivitete të anuluar	/	/
KOMUNA E DRAGASHIT			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1	Furnizimi me material shpenzues-laboratorik, për QKMF në Dragash (2 vite - 24 muaj)	621-21-2751-1-2-1	10,000.00
2	Transporti i nxënësve për vitin shkollor 2021-2022	621-21-5109-2-2-1	6,512.00
3	Furnizimi me material shpenzues -laboratorik, për QKMF në Dragash	621-21-5076-1-2-1	11,000.00
4	Mirëmbajtja e auto rrugëve lokale në Komunën e Dragashit	621-21-5717-2-3-6	9,000.00
5	Ndërtimi i murit mbrojtës në rrugën e Hysajve dhe kubëzimi i rrugës të Shullenjëve në fsh. Xërxë	621-21-8574-5-2-1	10,000.00
KOMUNA E FERIZAJT			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1	Asfaltimi i rrugëve dhe trotuarëve në fsh. Varosh, Fshati i Vjetër, Bibaj dhe Nikadin - Projekt tre vjeçar.	656-21-1161-5-1-1	600,000.00
2	Shtëpiaku dhe sanitaria në objektet shkollore dhe institucionet tjera të Komunës së Ferizajt	656-21-3081-2-1-1	800,000.00
3	Dizajni i çmimeve të rregullues së dekoratave, Llogot e teatrit, galerisë, muzeut, bibliotekës. arkivit, muzeut të kujtesës dhe logot identitare të çmimeve tradicionale. LOT I - LOT XIII	656-21-3435-2-2-3	10,000.00
4	Riparimi i rrugëve me asfalt - Projekt tre vjeçar.	656-21-1997-2-1-1	900,000.00
5	Ndërtimi i sallës së sporteve të shkollës "Ganimete Terbeshi" në Ferizaj	656-21-3084-5-1-1	600,000.00
6	Pajisje për laborator dhe pajisje për mjekësinë familjare në QKMF	656-21-3674-1-2-1	25,000.00
7	Repilimi i bagëtive të imëta kundër sëmundjes "Gjuha e Kaltër"	656-21-1696-2-2-1	30,000.00
8	Mbushja e bocave me oksigjen dhe furnizimi me manometër për nevoja të QKMF-së në Ferizaj	656-21-3506-1-3-6	2,000.00
9	Furnizimi, montimi dhe vendosja e monitorëve dinamik digjital në qytet (shenja ndriçuese-udhëregues digjital)	656-21-5021-1-2-1	30,000.00
10	Ndërtimi i stacionit të ri të autobusave - Faza II	656-21-1590-5-1-1	780,000.00
11	Transporti me autobus (brenda dhe jashtë vendit) i punëtorëve të administratës komunale, shkollave dhe institucioneve tjera që funksionojnë në kuadër të Komunës së Ferizajt	656-21-3670-2-2-1	14,000.00
12	Përkrahja e fermerëve me pajisje - Sistem kundër breshërit.	656-21-7513-1-2-1	80,000.00
13	Furnizimi i fermerëve me lopë të racës simentale	656-21-1689-1-1-1	140,000.00

⁹² **Sqarim:** Titujt e aktiviteteve janë në formën origjinale si janë publikuar nga komunat me apo pa gabime drejtshkrimore.

14	Hapja e puseve të ujit të pijshëm në fsh. Kosinë dhe rregullimi i rrjetit të ujësjellësit Kosinë-Dremjak - Projekt tre vjeçar	656-21-5314-5-2-1	160,000.00
15	Ndërtimi i shtëpive (kafazëve) për qent endacak.	656-21-7291-5-2-1	30,000.00
16	Furnizimi i fermerëve me koshere të bletëve	656-21-2137-1-2-1	43,750.00
KOMUNA E GLOGOCIT			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1	Shërbime konsulente nëpërmjet marrëveshjeve për shërbime të veçanta (Konsulentë Individë) për nevojat e Komunës së Drenasit	611-21-229-2-2-1	59,700.00
2	Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative	611-21-5845-5-5-8	3,000.00
3	Dekorimi i qytetit për festa shtetërore dhe kombëtare për vitet 2021-2023	611-21-6034-2-2-1	31,445.00
4	Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative	611-21-7467-5-5-8	21,940.00
5	Furnizim me pajisje muzikore për institucionet shkollore të Komunës së Drenasit	611-21-8111-1-2-1	24,823.40
6	Mirëmbajtja (servisimi) i pajisjeve, LOT I Radiologjike, LOT II Laboratorike dhe Mjekësore	611-21-6924-2-2-1	36,000.00
7	Rrethojat në QMF, AMF dhe ndërtimi i pjerrinave në QMF dhe AMF	611-21-8495-5-2-1	75,240.00
8	Renovimi i objekteve sportive	611-21-8115-5-2-1	17,816.15
9	Hartimi i projekteve zbatuese për nevojat e komunës	611-21-8628-2-1-1	137,846.00
10	Mirëmbajtja e deponis inerte - Projekt dy vjeçar	611-21-619-2-2-1	30,000.00
11	Furnizimi i shkollave me kabinete për Kimi, Fizikë dhe Biologji	611-21-504-1-2-1	60,000.00
12	Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatrat Terstenik I dhe II, Verboc, Shtutic, Baic, Krajkovë , Damanek dhe Shtrubullova - Projekt dy vjeçar	611-21-235-5-2-1	40,000.00
13	Furnizim me artikuj, 1 material elektrik, veglari dhe llaqe, 2. Artikuj të sanitarisë dhe 3. Artikuj bujqësorë - Për nevojat e institucioneve komunale, Administratës, arsimit dhe shëndetësisë së Drenasit	611-21-1216-1-1-1	189,800.00
KOMUNA E GJAKOVËS			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1	Ndërtimi i rrugës hyrëse në Gjakovë nga ana veriore, nga drejtimi i Pejës	632-21-1636-5-1-1	989,297.05
2	Furnizim me barna emergjente për Covid-19	632-21-1544-1-2-1	17,500.00
3	Punimi i bustit	632-21-2228-5-3-6	4,000.00
4	Blerja e aparaturave mjekësore (KPSH, stomatologji dhe laborator) dhe jo mjekësore	632-21-3003-1-2-1	20,000.00
5	Furnizim me material për serra dhe mirëmbajtja e serrave	632-21-4191-1-3-6	1,988.00
6	Furnizim me pajisje dhe material shpenzues për laborator dhe kabinete për SH.M.T "Nexhmedin Nixha" dhe SH.M.M "Hysni Zajmi"	632-21-5618-1-2-1	13,042.00
7	Furnizim me veshmbathje	632-21-9162-1-2-1	15,577.00
8	Ndërtimi dhe sanimi i rrugëve me kubëza betoni për lagjet e komuniteteve në Komunën e Gjakovës	632-21-6513-5-2-1	49,058.35
KOMUNA E GJILANIT			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1	Ndërtimi i Qendrës Kryesore për Komunitete	651-21-1616-5-2-1	151,471.52

2	Mirëmbajtja dhe servisi i katër kompjuterëve publik (E-Kioska), të cilët janë të vendosur në tri pika të qytetit dhe një në fsh. Cërnice.	651-21-3184-2-3-6	3,200.00
3	Transporti i nxënësve - ndarja ne Lote	651-21-6077-2-1-1	8,400.00
4	Mekanizmi përcjellës për bujqesi	651-21-5968-1-2-1	54,000.00
5	Furnizim me artikuj ushqimor për çerdhe, konvikt dhe shkolla	651-21-9984-1-1-1	450,000.00
6	Pastrimi i objekteve shkollore	651-21-8003-2-1-1	1,343,997.00
7	Pastrimi i objekteve komunale dhe shëndetësore në Komunën e Gjilanit	651-21-9661-2-1-1	705,306.24
KOMUNA E KAÇANIKUT			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1	Furnizim me oksigjen për QKMF	652-21-2743-1-3-6	1,000.00
2	Mirëmbajtja dhe servisi i aparaturave mjekësore në QKMF-në, Kaçanik	652-21-6581-2-2-1	34,000.00
KOMUNA E KAMENICËS			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1	Shërbime juridike dhe të përfaqësimit për nevojat e Komunës së Kamenicës	653-21-1101-2-2-1	30,000.00
2	Transporti dhe akomodimi Delegatëve Komunal në Durrës për hartimin e rregulloreve	653-21-3735-2-3-6	4,000.00
3	Participimi me donatorë - Furnizimi, punimi dhe montimi i tezgave në tregun e gjelbërt në Kamenicë	653-21-8146-1-2-1	10,000.00
4	Furnizim me pajisje mjekësore RTG dhe të Laboratorit	653-21-7723-1-2-1	61,000.00
5	Participimi me donatorë - Renovimi i hapësirës në objektin e gjinekologjisë dhe adaptimi për dhomë të mamografit dhe rentgenit	653-21-10627-5-3-6	9,900.00
6	Restaurimi i Kishës Ortodokse në Shipashnicë të Poshtme	653-21-8567-5-2-1	29,950.00
KOMUNA E KLINËS			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1	Ndërtim i serrave për përfituesit individual	634-21-2854-5-2-1	108,000.00
2	Shërbime të veçanta - specialist të gjeodezisë	634-21-9473-2-3-6	6,600.00
KOMUNA E LEPOSAVIQIT			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1	Përgatitja e dokumentacionit teknik të projektit	641-21-8005-2-2-1	32,000.00
KOMUNA E MITROVICËS SË VERIUT			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1	Prokurimi i pajisjeve digjitale (tabletëve) për nevojat e shkollave të mesme	647-21-1908-1-2-1	25,000.00
2	Prokurimi i pajisjeve digjitale (tabletëve) për nevojat e shkollave fillore	647-21-1890-1-2-1	60,000.00
3	Prokurimi i pajisjeve audio dhe instrumenteve për shkollat e mesme	647-21-4335-1-3-6	9,990.00
4	Ri-ndërtimi i trotuareve në rrugën e IPK - Rregullimi i hapësirave të hapura publike dhe të gjelbërta në rrugën e IPK midis dy rrethrotullimeve, FAZA I	647-21-4623-5-2-1	60,000.00
5	Furnizim me pajisje të teknologjisë informative	647-21-9584-5-5-8	6,000.00

6	Furnizimi i tonerit për nevojat e shkollës fillore në Mitrovicën e Veriut	647-21-9376-1-3-6	5,500.00
KOMUNA E PEJËS			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1	Blerja e një autoambulance për urgjencën e qytetit	635-21-925-1-2-1	40,000.00
2	Furnizim me artikuj të mirëmbajtjes së objekteve shëndetsore	635-21-3776-1-2-1	48,669.00
3	Blerja e dy autokombi për QKMF-në, LOT II	635-21-6321-1-2-1	43,000.00
KOMUNA E PODUJEVËS			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1	Ekzaminimi i materialeve ndërtimore	615-21-744-2-2-1	30,000.00
2	Kontraktimi me qera i binës me ndriçim dhe zërim si dhe tendave për Javën e Diasporës	615-21-4755-2-3-6	4,250.00
3	Furnizimi dhe montimi i pajisjeve mjekësore	615-21-3603-1-1-1	172,079.40
4	Furnizimi me goma për automjete të institucioneve	615-21-8252-1-3-6	8,570.00
KOMUNA E PRISHTINËS			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1	Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës	616-21-260-2-1-1	600,000.00
2	Furnizimi me artikuj ushqimor për nevojat e kuzhinës qendrore - Pemë dhe perime	616-21-3026-1-2-1	75,000.00
3	Renovimi i qendrës kulturore Llukar	616-21-1514-5-2-1	50,000.00
4	Pajisja e disa shkollave me rekuizita sportive - Fitnes i hapur	616-21-2411-1-1-1	150,000.00
5	Konkurs projektimi për renovim infrastrukturor dhe artistik të tunelit të kurrizit	616-21-2805-2-2-3	40,000.00
6	Deratizimi i podrumëve dhe garazheve publike si dhe rrjetit të kanalizimit në Komunën e Prishtinës	616-21-2066-2-1-1	450,000.00
7	Rregullimi i varrezave dhe hapësirave në Komunën e Prishtinës	616-21-1002-5-2-1	250,000.00
8	Sanimi i gropave dhe deformimeve të shtresave të asfaltit në rrugët dhe trotuarët në Komunën e Prishtinës	616-21-3885-5-2-1	300,000.00
9	Furnizim me inventarë për qendrat e ndryshme sociale	616-21-6499-1-2-1	48,852.00
10	Furnizim me kostume tradicionale për Qendrën Kulturore të Fëmijëve	616-21-7921-1-3-6	7,000.00
11	Pajisja e disa shkollave dhe kopshteve me rekuizita sportive dhe lodra	616-21-8383-1-1-1	150,000.00
12	Ndërtimi i çerdhes Xixëllonjat	616-21-6122-5-1-1	750,000.00
KOMUNA E PRIZRENIT			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1	Organizimi i trajnimeve për zejet e filigranit, vekut, plisit, frizer, dizajn grafik, marketing, gastronomi dhe qepje.	622-21-949-2-2-1	30,675.50
2	Furnizim me reagensa për laborator në kuadër të Shëndetësisë Primare në Komunën e Prizrenit	622-21-978-1-2-1	100,000.00
3	Furnizim me pajisje stomatologjike për nevojat e departamentit të stomatologjisë.	622-21-999-1-2-1	30,000.00
4	Dizajnimi i dhuratave dhe ambalazhit të dhuratave të Komunës së Prizrenit	622-21-1042-4-3-3	5,000.00
5	Rehabilitimi dhe riparimi i rrugëve fushore	622-21-2694-5-2-1	50,000.00

6	Trajtimi i objekteve me vlera historike dhe kulturore. Restaurimi, konservimi dhe revitalizimi i monumenteve si Hamami, Xhamitë dhe Shtëpitë individuale në Komunën e Prizrenit	622-21-2759-5-2-1	118,000.00
7	Studimi i fizibilitetit dhe projekti ideor i tunelit që lidhë rajonin e Zhupërs me qytetin e Prizrenit	622-21-1817-3-1-2	800,000.00
8	Hartimi i një udhëzuesi, ri-organizimi i elementeve të përkohshme (mobilerinë urbane) në qendrën historike në Prizren	622-21-4247-4-2-3	17,500.00
9	Shërbime konsulente nëpërmjet marrveshjeve për shërbime të veçanta (konsulent individë) për nevojat e Komunës së Prizrenit 47 LOT	622-21-2044-2-1-1	480,957.60
10	Promovimi i videoklipit për ofertat turistike të Prizrenit	622-21-4645-2-2-1	27,000.00
11	Hartimi i projektit detal të urës që lidhë Bregdri me Krushë të Vogël.	622-21-2902-2-2-3	30,000.00
12	Furnizim me 24 laptopë për shkollën fillore "Lekë Dukagjini" në Prizren	622-21-7487-5-5-8	9,800.00
13	Ndërtimi i infrastrukturës në fsh. Zym, kanalizim dhe rrugë - Projekt dy vjeçar	622-21-7621-5-2-1	102,000.00
14	Furnizim me dru për ngrohje për familjet e Dëshmorëve, Invalidët e Luftës dhe familjet skamnore në Komunën e Prizrenit	622-21-8100-1-2-1	90,000.00
15	Ndërtimi i infrastrukturës në fshatin Karashëngjergji - Projekt dy vjeçar	622-21-7807-5-2-1	217,000.00
16	Rregullimi i ndriçimit dhe hapësirave të gjelbërta.	622-21-8225-5-2-1	146,000.00
17	Furnizim me reagensa(D-Dimer dhe teste serologjike) për laborator në kuadër të Shëndetësisë Primare në Komunën e Prizrenit	622-21-3013-1-1-1	227,000.00
18	Ndërtimi i infrastrukturës në rrugën Besim Telaku - Projekt dy vjeçar	622-21-6339-5-2-1	296,000.00
19	Promovimi i videoklipit për ofertat turistike të Prizrenit	622-21-6391-2-3-6	9,950.00
20	Furnizim me inventar shkollor për nevojat e institucioneve arsimore të Komunës së Prizrenit	622-21-4277-1-2-1	60,000.00
KOMUNA E RAHOVECIT			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1	Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit Lot XVII, XVIII dhe XX	623-21-665-2-1-1	11,880.00
2	Marrëveshje kornizë - Furnizim me pemë dhe perime	623-21-461-5-5-8	1,649.20
3	Mirëmbajtja e ngrohjeve qendrore në shkollat e Komunës së Rahovecit	623-21-5374-2-2-1	15,000.00
4	Ndërtimi i sheshit qendror të qytetit	623-21-4129-5-1-1	3,725,980.92
KOMUNA E SUHAREKËS			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1	Furnizim me oksigjen medicinal për QKMF në Suharekë	624-21-583-1-3-6	5,000.00
2	Ndërtimi i rrethojave për varrezat e fshatit Tërrnje - Vazhdim LOT 2	624-21-524-5-2-1	5,000.00
3	Transporti i masës drurore të konfiskuara	624-21-1953-2-3-6	4,000.00
4	Projekt me bashkëfinancim "Ndërtimi i rrugës Gjinoc-Novakë-Mamushë"	624-21-1472-5-2-1	398,200.00
5	Ndërtimi i rrugës Baqevc-Sallagrazhdë-Grejokc-Korishë, Suharekë	624-21-1475-5-2-1	400,000.00

6	Projekt me Bashkëfinancim "Rregullimi i shtratit të lumit Toplluha-Suharekë"	624-21-2981-5-2-1	250,000.00
7	Rregullimi i ambientit për aktivitete kulturore të festave komunale "13 Qershori"	624-21-3333-2-3-6	6,000.00
8	Transport për donacion nga Zvicrra për Kosovë	624-21-1374-2-3-6	3,500.00
9	Pastrimi i automjeteve të administratës komunale dhe QKMF	624-21-4310-2-3-6	2,000.00
10	Mirëmbajtja e GPS-ve të veturave	624-21-4302-2-3-6	2,500.00
11	Barëra Anti-Covid për QKMF në Suharekë	624-21-6335-1-2-1	50,000.00
12	Blerja e automjetit zyrtar për QKMF	624-21-8708-1-2-1	19,445.00
13	Furnizim me material të nevojshëm për NjPZSH, në Komunën e Suharekës	624-21-9323-1-3-6	4,361.00
14	Furnizim me veshmbathje dimërore për inspektion dhe QPS	624-21-9655-1-3-6	1,990.00
15	Furnizim me pajisje të teknologjisë informative	624-21-8924-5-5-8	70,000.00
16	Shërbimet e transportit sipas vitit kalendarik 2022 - LOT 7	624-21-9090-2-2-1	9,200.00
KOMUNA E SHTIMES			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1	Nuk ka aktivitete të anuluar	/	/
KOMUNA E VITISË			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1	Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike në Komunën e Vitisë	657-21-328-2-1-1	440,000.00
2	Mirëmbajtja dhe servisi i pajisjeve të laboratorit në QKMF.	657-21-8721-2-3-6	5,457.00
3	Renovimi i ambulancave	657-21-5558-5-2-1	106,333.15
KOMUNA E VUSHTRRIË			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1	Blerja e shërbimeve të konsulencës individuale për menaxhimin e kontratave për nevojat e Komunës së Vushtrrisë	644-21-6416-2-2-1	114,677.50
2	Furnizimi me bombola të oksigjenit medicinal për nevojat e QKMF-së në Vushtrri	644-21-5941-1-2-1	15,000.00
3	Furnizimi me makina (pajisje) për mësim praktik në SHMT "Lutfi Musiqi"	644-21-3251-1-2-1	28,255.00
4	Izolimi me plumb të hapësirave të rentgenit të QKMF-së, ventilimi rrezeve X.	644-21-6484-5-2-1	40,000.00
5	Furnizimi me pajisje laboratorike dhe mjete konkretizimi	644-21-6233-1-2-1	58,267.90
6	Ndërtimi i depove për shkolla	644-21-3803-5-2-1	19,978.84
7	Renovimi i Qendrës Rezidenciale	644-21-8325-5-3-6	8,794.27
8	Renovimi i laboratorit në QMF-3 në Vushtrri	644-21-4529-5-3-6	3,988.07
9	Furnizim me pajisje elektrike për amvisëri	644-21-3002-1-3-6	8,487.00
10	Furnizimi me inventar për QKM	644-21-6431-1-2-1	29,168.00
11	Furnizimi me gjeneratorë dhe inventar	644-21-544-1-3-6	2,100.00
12	Furnizimi me kositëse të barit	644-21-7201-1-3-6	2,640.00

Iniciativa për Progres (INPO) është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e themeluar në vitin 2005 me qëllim që të përparoj pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset shoqërore, përmes së cilës pjesëmarrje avokohet për çështjet sociale, politike, ekonomike, forcimin e parimit të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, rritjen e kërkesave të qytetarëve si dhe luftimin e korrupsionit, duke synuar në promovimin e vlerave të një shoqërie të hapur dhe demokratike. Vizioni dhe misioni i organizatës përmbushet përmes aktiviteteve të ndryshme të punës të cilat organizohen nga dy (2) programet e specializuara të organizatës: 1. Qeverisja e Mirë dhe 2. Edukimi Demokratik.